

Aneksi B

- Vendim nr. 35, dt. 08.04.2026, Mbi trajtimin financiar të autorëve, redaktorëve dhe koordinatorëve të projektit madhor “Enciklopedia shqiptare”;
- Kriteria shkencore për t’u zbatuar nga redaksitë dhe autorët në procesin e hartimit të Enciklopedisë shqiptare (ESH);
- Udhëzues praktik për hartimin e Enciklopedisë Shqiptare (ESH);
- Udhëzues për disa saktësime të posaçme mbi statusin e artikullit përmbledhës, madhësitë e artikujve për personalitetet si dhe teknikaliteteve redaksionale për përgatitjen e artikujve enciklopedikë;
- 12 artikuj instruktivë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
REDAKSIA QENDRORE**

Nr. 600 Prot

Tiranë, më 08/04/2026

V E N D I M

Nr. 35, datë 08.04.2026

**MBI TRAJTIMIN FINANCIAR TË AUTORËVE, REDAKTORËVE DHE
KOORDINATORËVE TË PROJEKTIT MADHOR “ENCIKLOPEDIA SHQIPTARE”**

Mbështetur në “Protokollin e përbashkët për administrimin e fondeve të vëna në dispozicion për projektin madhor në albanologji ‘Enciklopedia Shqiptare’”, nr. 1470, datë 1.3.2023, pika 7 “Shpërblimi i autorëve për hartimin e veprës shkencore”, Redaksia Qendrore, në mbledhjen e datës 07.04.2026,

V E N D O S I


1. Për secilën prej madhësive të artikujve, pagesat do të jenë:

Artikull i vogël (deri në 1.5 faqe)	70 euro
Artikull i mesëm (2 – 3 faqe)	170 euro
Artikull i madh (3.5 – 5 faqe)	400 euro

2. Artikujt monografikë dhe artikujt e mëdhenj me natyrë monografike, midis (8-9 faqe), do të paguhen me tarifën e artikullit të madh + 30 euro për çdo faqe që tejkalon kufirin e tij maksimal.
3. Pagesa do të bëhet në dy pjesë:
-Pjesa e parë: 40% kur artikulli dorëzohet;
-Pjesa e dytë: 60% kur artikulli konsiderohet i përfunduar dhe “Enciklopedia Shqiptare” të ketë dalë si maket online.
4. Për redaktimin, pagesa do të llogaritet 30 % e tarifës së shkrimit të artikullit që redaktohet; kjo pagesë do të ndahet ndërmjet anëtarëve të Redaksive të Fushave.
5. Për drejtuesin (koordinatorin) e redaksisë së fushës pagesa do të përcaktohet në vijim.

KRYEREDAKTOR
Akad. Skënder GJINUSHI





Në Prishtinë, më 7 prill 2023

Kritere shkencore për t'u zbatuar nga redaksitë dhe autorët në procesin e hartimit të *Enciklopedisë shqiptare (ESH)*

Referuar pikës 1 të nenit 7 të Rregullores *Për mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të redaksisë qendrore, të redaksive vendore dhe të redaksive të fushave të "Enciklopedisë shqiptare"*;

Në zbatim të vendimit që mori *Redaksia qendrore* në mbledhjen e saj të datës 16 janar 2023;

Hartohen e miratohen këto *kritere shkencore*, të detyrueshme për zbatim nga redaksitë e të tre niveleve në procesin e përgatitjes së ESH, për të garantuar përfaqësim të barabartë të *fakteve, dukurive e zhvillimeve kombëtare në gjithë hapësirën shqiptare, sipas rëndësisë historike e kulturore.*

Pjesa I

Kritere të përgjithshme

1. ESH është një *projekt kolektiv me karakter etnoidentifikues e etnodallues*, e vlerësuar prej bashkëhartuesve të saj si një *vepër ekumenike (përbashkuese)*; si një *arritje shkencore që përfaqëson një konventë mendimi e vlerësimi kombëtar për trashëgiminë dhe identitetin shqiptar.*
2. *Albanizmat në trashëgiminë materiale e shpirtërore dhe albanitet në pasuritë natyrore shqiptare kanë përparësinë kryesore.*
3. ESH ka karakter *integruës*. Kriter themelor në hartimin e ESH është *gjithëpërfshirja.*
4. ESH hartohet me qëllim kryesor *promovimin e gjithëmbarshtëm dhe objektiv të trashëgimisë materiale, shpirtërore dhe natyrore të popullit shqiptar dhe të hapësirës historike shqiptare, pavarësisht dallimeve e ndarjeve për shkaqe historike dhe gjeopolitike, të krahinës, dialektit, kulturës, traditave vendore dhe besimit, duke realizuar homogjenizimin në tërësi të gjithë lëndës enciklopedike.*
5. ESH promovon gjithashtu *faktet, personalitetet, zhvillimet e dukuritë joshqiptare në fushën e albanologjisë, historisë, politikës dhe diplomacisë europiane e botërore, që*

kanë pasur lidhje me botën shqiptare dhe kanë ndikuar në zhvillimet historike-kulturore të saj.

6. ESH përgatitet për t'u shërbyer si një *amzë e përgjithshme e trashëgimisë shqiptare* gjithë të interesuarve për lëndën enciklopedike që promovohet përmes saj, shqiptarë e të huaj.

7. ESH ka për qëllim të shërbejë si një *libër identiteti* në kuadër të familjes europiane të popujve në një të ardhme të afërme të përbashkët.

8. Në përgatitjen e ESH pranohen e *respektohen tezat themelore që përbëjnë paradigmen e shkencave albanologjike* për protogjenezën dhe origjinën e popullit shqiptar, autoktoninë, vendin dhe kohën e formimit, burimin dhe tipologjinë e gjuhës, vazhdimësinë historike në trojet e veta dhe *karakterin europian të identitetit* të tij.

9. *Qendrimet romantike dhe subjektiviste për vetveten*, si dhe *qendrimet ksenofobike*, janë jashtë kodit etik të platformës dhe qëllimit të ESH.

10. ESH *ka karakter konfirmues*. Ajo hartohet mbështetur në faktet e zbuluara dhe të vërtetuara nga shkencat shqiptare e nga albanologjia jashtë vendit. Rivendosja e së vërtetës historike për popullin shqiptar cenuar prej studimeve e botimeve jodashamirëse në rastet e nevojshme bëhet *nëpërmjet pohimit të fakteve të provueshme për të kundërtën*, përmes shërbimit me burime të njohura e të reja.

11. *Përzgjedhja dhe shkallëzimi i lëndës enciklopedike* (personalitete, fakte, zhvillime, ngjarje, dukuri, trashëgimi të tjera) që propozohet për pranim në ESH bëhet duke iu referuar *kriterit të përfaqësimit*, sipas rëndësisë objektive historike-kombëtare.

12. *Shkallëzimet e madhësisë së përfaqësimit* në artikuj monografikë, të mëdhenj, të mesëm, të vegjël e përmbledhës bëhen mbi bazën e *kriterit të meritave të verifikuara*: a). në shtrirje historike kombëtare gjithëkohore apo mbikohore; b). në shkallë kombëtare në periudha historike të caktuara; c). në shkallë rajonale; d). për zhvillime kalimtare historike e kulturore.

13. Trashëgimia historike e provuar dhe e verifikuar është përparësore. ESH është e hapur për personalitetet, zhvillimet dhe dukuritë e së sotme që janë *kthyer tashmë në trashëgimi* apo janë të *mbyllura kronologjikisht*. Lënda enciklopedike që nuk është *kthyer ende në trashëgimi* konsiderohet si rregull si pasuri në pritje të konfirmimit të këtij statusi të detyrueshëm për botime të ardhshme të përditësuara.

14. ESH zbatohet duke ndjekur *modelin e një enciklopedie të përgjithshme shkencore*, me renditje të artikujve sipas *rendit alfabetik*. Ajo ofron informacion të stabilizuar, njohuri të verifikueshme, koncepte e referime tekstore e të ilustruara për temat që konsiderohen me *vlerë domethënëse* për historinë e kombit shqiptar dhe kulturën e tij.

15. Në ESH bëjnë pjesë *përkufizimet e rëndësishme terminologjike mbi të cilat mbështetet zhvillimi i disiplinave themelore të shkencave të sotme në Botë*. Termat që lidhen me drejtpërsëdrejti me *specifikën e natyrës, dijeve dhe zhvillimeve shqiptare (etnoflora, etnofauna)* shtjellohen më gjerësisht.

16. Zgjedhja e autorëve dhe ndarja e punës në redaksi ose midis redaksive bëhet referuar kriterit të kompetencës dhe fushës së ekspertizës. Rajonalizimi i punës së redaksisë për shkak të përkatësisë territoriale nuk përbën pengesë për zbatimin e këtij kriteri.

17. ESH konceptohet dhe realizohet si një vepër e hapur, në linjë, e përditësueshme; redaksitë e saj janë të vëmendshme ndaj këshillave dhe vërejtjeve të të interesuarve për shfrytëzimin e saj.

18. ESH ka për qëllim të krijojë një pikë reference për sistemin e arsimit dhe edukimit dhe një standard diturie që promovon vlerat historike e kulturore kombëtare, të identitetit dhe gjuhës amtare; si dhe sintetizon arritjet më të vlerësuara të shkencës shqiptare në të gjitha fushat.

Pjesa II

Kritere mbi fjalësin themelor, hierarkinë e njësive dhe standardet

1. Përgatitja e hartimi i ESH mbështetet në dokumentet e pranuar dhe të nënshkruara nga dy qeveritë dhe nga kryesitë gjegjëse të dy akademive, me cilësinë e Palës zbatuese dhe të përgjegjësive ndaj qeverive vendëse: Marrëveshja ndërqeveritare, Rregullorja e përbashkët, Protokoll i përbashkët, Rregullorja teknike e redaksisë qendrore, Emërtimet dhe përkufizimet e redaksive të fushave dhe Kriteret themelore. Këto dokumente, si dhe akte të tjera me karakter njësues të parashikuara tashmë (modelet e artikujve dhe manuali praktik) konsiderohen kornizë juridike dhe administrative e detyrueshme për zbatim. Ndryshimet në to, sa u përket akteve të miratuara nga kryesitë, mund të bëhen vetëm me argumentim të thelluar dhe mirëpranim prej tyre.

2. Hierarkitë midis redaksive (sipas përshkrimit në aktet rregulluese tashmë të bashkë nënshkruara) dhe shkallëzimet midis artikujve janë të njësura dhe të detyrueshme për zbatim. Redaksitë janë vetëvepruese në kuadër të kornizës ligjore-administrative të miratuar. Në rast të shfaqjes së problematikave përtej kësaj kornize kryesitë e Palës zbatuese kanë të drejtën e ripërcaktimit të rendit.

3. Përpjesëtimet numerike midis artikujve përafërsisht janë: 30-50 artikuj monografikë (Iliria, Dardania, ilirët, gjuha shqipe, Shqipëria, Kosova, Gjergj Kastrioti, Nënë Tereza); 300 artikuj të mëdhenj; 2000 artikuj të mesëm; 7000 artikuj të vegjël e 600 artikuj përmbledhës.

4. Modelet e artikujve të miratuar nga redaksia qendrore, shembujt referencialë sipas hierarkisë së tyre, sistemi i referencave dhe burimeve, rregulloret teknike në nivelet e dyta e të treta të redaksive, janë akte të detyrueshme për zbatim nga ato vetë, autorët dhe bashkëpunëtorët.

5. Madhësia e zërave sipas hierarkisë së tyre shprehur në karaktere (shenja) është si vijon: a.) artikujt monografikë deri në 10-15 faqe daktilografike; b.) artikujt e mëdhenj 3-5 faqe daktilografike; c.) artikujt e mesëm 1-3 faqe daktilografike; artikujt

përmbledhës mund të jenë në vëllim më të mëdhenj se *artikujt e vegjël* a të mesëm, (mesatarisht 2 faqe daktilografike) dhe d.) *artikujt e vegjël* deri 1 faqe daktilografike.

6. Personalitetet shqiptare që paraqiten më vete me artikuj / zëra në enciklopeditë e popujve të tjerë *kalojnë detyrimisht për shqyrtim e vendimmarrje* në redaksitë e ESH.

7. *Emërtimet e përveçme* etnonimike, urbane, gjeografike e historike (*toponime, hidronime, oronime, oikonime*) paraqiten në të gjitha format që kanë pasur në rrjedhë të shekujve, duke respektuar gjuhësisht *parimin historik*. Kur një emërtim ka pasur forma të ndryshme në gjuhë e alfabete, *vihet në krye forma më e vjetër* dhe midis kllapash format e tjera sipas kronologjisë. Emërtimet e përveçme shtetërore, etnonimike, gjeografike dhe urbane të kohës së sotme shenjohen në shqip dhe midis kllapash në formën ndërkombëtare ose gjuhën më të përdorur.

8. Redaksitë e fushave, redaksitë vendore dhe redaksia qendrore vlerësojnë mundësinë e përdorimit të informacionit dhe të bashkëpunimit me autorët hartues të *enciklopedive krahinore e tematike, të leksikonëve për emërtime të përveçme, të botimeve enciklopedike mbi bazën e profesionit dhe të fjalorëve terminologjike*.

9. Përkufizimet terminologjike në disiplinat shkencore klasike e të sotme të shkencave referohen ose përshtaten sipas enciklopedive më të vlerësuara në shkallë botërore (*Encyclopaedia Britannica, Encyclopédie universelle, Encyclopédie française Larousse, Treccani*).

10. Ilustrimet (*foto, skica, grafikë, diagrama, vizatime*) si rregull sigurohen nga autorët ose nga redaksia posaçërisht për ESH. Autorët dorëzojnë bashkë me artikullin imazhet e nevojshme ose kërkesën për realizimin e tyre nga redaksia përkatëse. Ilustrimet duhet të *kenë karakter plotësues të informacionit për lëndën enciklopedike që promovohet në artikull*.

11. Rendi i punës në fazën përgatitore, *deri në miratimin e emërtesës së artikujve dhe të autorëve të hartimit të tyre*, ndjek këto shkallë: a). *propozimet* vijnë nga redaksitë e fushave; b). *konfirmimet* bëhen në redaksitë vendore; c). *problemet* për zgjidhje ndër-redaksionale i takojnë redaksië qendrore.

12. Rendi i punës në fazën e realizimit është: a). *koordinimi* me autorët përgatitës të artikujve bëhet nga redaksia e fushës; b). *konfirmimi* bëhet nga redaksia vendore; c). *homogjenizimi* bëhet nga redaksia qendrore. *Përgjegjësia shkencore* është e redaksive të fushave. *Përgjegjësia gjuhësore dhe ajo e njësimi* është e redaksisë qendrore dhe e QBAE.

13. Anëtarët e redaksive të fushave janë njëherësh autorë kryesorë të artikujve enciklopedikë.

14. *Kalendarët e punës të redaksive* propozohen prej tyre dhe miratohen nga redaksia qendrore. Për kthimin e tyre në *akt urdhërues administrativ* merret pëlqimi i kryesive të dy *Palëve zbatuese*, në përputhje me statusin e tyre si sipërmarrëse të projektit, sipas *Marrëveshjes ndërqeveritare*.



15. Grupimi i rekomanduar i redaksive për nevoja të lehtësimit të ndërkommunikimit është: *albanologjia, shkencat shoqërore dhe shkencat teknike. Raporte të paracaktuara në vëllim e përpjesëtim mes tyre nuk ka.*

16. *Procedura e detyrueshme që ndjek artikulli i hartuar nga autori është: a). shqyrtimi në redaksinë e fushës, eventualisht recensionimi / ekspertimi dhe kthimi për rishqyrtim me këshilla e vërejtje; b). miratimi i përmbajtjes shkencore nga redaksia e fushës; c). verifikimi e përjashtimi i paralelizmave nga redaksia vendore; d). depozitimi përfundimtar në bazën e të dhënave nga redaksia qendrore.*

17. Redaksia qendrore harton e miraton *modelet e artikujve* sipas hierarkisë dhe përshkrimit, si dhe *një manual praktik me shembuj ilustrues* të dobishëm për krahasim për secilën shkallë të tyre.


18. Këto kritere shkencore dhe këto dakordësi e zgjidhje parimore, të gjithëpranuara dhe të miratuara nga redaksia qendrore, në procesin e realizimit të projektit mund të pasurohen, saktësohen e ndryshohen me pëlqimin e saj. Hyrja në fuqi e ndryshimeve ndodh pas vënies në dijeni të titullarëve të *Palëve zbatuese.*

Akademik Mehmet Kraja

Zv. Kryeredaktor



Akademik Skënder Gjinushi

Kryeredaktor

488/12 12.07.23



**Akademia e Shkencave e
Shqipërisë**



**Akademia e Shkencave
dhe Arteve e Kosovës**

Udhëzues praktik për hartimin e Enciklopedisë Shqiptare (ESH)

Referuar nenit 6 pika 6 të Rregullores së përbashkët për ngritjen dhe funksionimin e redaksive të Enciklopedisë shqiptare (më tej: ESH); në të cilën specifikohet qartazi detyra e redaksisë qendrore për të hartuar udhëzuesin e artikujve, duke përcaktuar edhe formatimin e njësuar teknik të paraqitjes së artikujve, duke përfshirë sistemin e referencave dhe bibliografinë; si dhe të ofrojë modele për secilin tip të tyre, propozohet ky udhëzues praktik, hartuar nga grupi i punës, i ngritur me vendim të redaksisë qendrore në mbledhjen e saj të datës 06.04.2023 në Prishtinë.

Udhëzuesi ka karakter praktik dhe instruktiv-didaktik. Qëllimi i tij është t'u lehtësojë punën redaktorëve e hartuesve të teksteve të ESH; të garantojë zbatimin e të njëjtave kritere e zgjidhje teknike nga redaksitë e të tre niveleve.

Grupi i punës, i ngarkuar për hartimin e udhëzuesit praktik, në zbatim të vendimit të datës 06.04.2023 të redaksisë qendrore, cituar më sipër; i propozon redaksisë qendrore miratimin e këtij dokumenti:

1. Vëllimi i ESH

ESH hartohet në dhjetë vëllime, me një numër mesatar faqesh 800-1000 për çdo vëllim dhe ka për qëllim promovimin e trashëgimisë materiale e shpirtërore,

historike e kulturore të popullit shqiptar, në përputhje me përcaktimet në Marrëveshjen ndërqeveritare.

2. Fjalësi i ESH

a). Numri i përgjithshëm i njësive enciklopedike që përmban ESH është rreth 10 mijë, sipas kësaj strukture, përcaktuar në kriteret shkencore të pranuar për zbatim në mbledhjen e redaksisë qendrore në Prishtinë më 6.4.2023: 30-50 artikuj monografikë (Iliria, Dardania, ilirët, gjuha shqipe, Shqipëria, Kosova, Gjergj Kastrioti, Nënë Tereza); 300 artikuj të mëdhenj; 2000 artikuj të mesëm; 7000 artikuj të vegjël e rreth 600 artikuj përmbledhës, sipas përcaktimit në Protokollin e përbashkët. Për tërësinë e njësive enciklopedike që përmban ESH përdoren termat sinonimikë fjalës, nomenklaturë, emërtesë.

b). Artikuj monografikë (10-15 faqe, me 2200 shenja e boshllëqe për faqe, sipas përcaktimit në VKM nr. 120 datë 27.1.1997) shkruhen për njësi enciklopedike që kanë të bëjnë me identifikimin historik, gjuhësor e kulturor ndërkombëtar të popullit shqiptar e të paraardhësve të tij (Ilirët, Gjergj Kastrioti).

c). Artikuj të mëdhenj (3-5 faqe) shkruhen për ato njësi enciklopedike që u kushtohen personaliteteve dhe ngjarjeve me karakter mbarëkombëtar.

ç). Artikuj të mesëm (1-3 faqe) shkruhen për ato njësi enciklopedike që u kushtohen ngjarjeve dhe individualiteteve që kanë lënë gjurmë në zhvillimet historike dhe kulturore kombëtare (Idriz Ajeti, Mahir Domi).

d). Artikuj të vegjël (deri 1 faqe) shkruhen për persona, ngjarje a dukuri historike-kulturore me karakter rajonal, krahinor apo lokal, që përmenden si vlera në trashëgiminë e popullit shqiptar (Sotir Andoni, Agim Gjakova).

dh). Artikuj përmbledhës shkruhen për ngjarje e figura që nuk përbëjnë përfaqësim secila më vete dhe janë realizuar e kanë luajtur rol në bashkëveprim mes tyre në kontekstin e historisë së kulturës dhe qytetërimit shqiptar (grupimi Vox clamantis in desertio, Brezi i viteve 1930). Artikulli përmbledhës mund të jetë në vëllim më të madh se artikulli i vogël a i mesëm (mesatarisht 2 faqe).

3. Autorët hartues të njësive enciklopedike në ESH

a). Autorët hartues të njësive enciklopedike zgjidhen prej redaksive të fushave nga radhët e studiuesve më të zotë në disiplinën e ekspertizës.

b). Anëtarët e redaksive të fushave dhe drejtuesit e tyre janë njëherësh autorë kryesorë hartues të njësive enciklopedike.

c). Autorët realizues të njësive enciklopedike në botime të mëparshme të kësaj fushe ftohen për të bashkëpunuar për artikujt përkatës në ESH.

ç). Autorët hartues të njësive enciklopedike të ESH ruajnë autorësinë e shkruarve të mëparshëm të tyre dhe e shprehin këtë sipas rastit: *duke u ruajtur emrin si bashkautor, përmes referencave ose duke i cituar në bibliografi*. Çështjet e autorësisë së trashëguar, drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë, zgjidhen praktikisht sipas kodit evropian të deontologjisë në kërkimin shkencor.

c). Autorët e një monografie për një ngjarje historike, për një dukuri të botës shqiptare, për një figurë të historisë apo të kulturës, *ftohen me përparësi nga redaksitë e fushave për përgatitjen e njësive enciklopedike* kushtuar atyre në ESH (shembull: Sabri Hamiti për At Zef Pllumin).

ç). Ndarja territoriale dhe ajo e përgjegjësive ndërmjet dy redaksive vendore *nuk përbën pengesë për zgjedhjen e autorëve sipas kompetencës së fushës*, në përputhje me përcaktimin me *kriteret rekomanduese* të miratuara në mbledhjen e redaksisë qendrore në Prishtinë më 06.04.2023 (p.sh: Ali Aliu për Petro Markon, Zija Çelën).

d). Zgjedhja e autorëve për përgatitjen e njësive të reja enciklopedike, pa përfaqësim në ndonjë botim të ngjashëm enciklopedik të mëparshëm; ose për rishkrimin e njësive që kanë më herët një zë në fjalorë enciklopedikë ekzistues, bëhet *duke këshilluar njësinë bazë të kërkimit shkencor të fushës që i përket njësia*.

dh). Emrat e autorëve shenjohen të plotë në fund të çdo artikulli dhe në *treguesin emëror* në fund të çdo fund vëllimi.

4. Baza e të dhënave e ESH

a). Bazë e të dhënave për hartimin e ESH quhen burimet kryesore që shërbejnë për përzgjedhjen e miratimin e *fjalësit themelor* i saj (parashikuar përafërsisht 10.000 njësi). Ajo është *kusht themelor për fillimin e punës* hartuese të trashëgimisë që zgjidhet të promovohet nga e gjithë lënda enciklopedike shqiptare. Mbi këtë bazë bëhet *vlerësimi paraprak i ngjarjeve, personaliteteve, trashëgimive shqiptare* që duhet të përfshihen në *fjalësin* e ESH.

b). Baza e të dhënave të ESH krijohet e funksionon pranë QBAE. Në këtë bazë disponohen *burimet për trashëgiminë materiale e shpirtërore të popullit shqiptar* në tërësinë e tyre: të krijuara posaçërisht për këtë projekt; të përzgjedhura nga fjalorët ekzistues të së njëjtës tipologji; nga leksikonët tematikë dhe fjalorët

terminologjikë; nga inventarët dhe skedarët e pasurisë historike-kulturore shqiptare në institucionet e specializuara; nga udhërrëfyesit, antologjitë dhe almanakët; nga korpuset e numerizuara të shqipes së shkruar e të folur (*arbërishtja digjitale, korpuset leksikore* brenda dhe jashtë vendit, sidomos për emërtimet e përveçme). Fjalësi i këtyre botimeve vlerësohet në mënyrë kritike nga redaksitë e fushave e redaksitë vendore dhe njësitë e përzgjedhura miratohen nga redaksia qendrore. Vlerësimi kritik përfshin si mundësi: *konfirmimin në fjalësin e ESH; ndërrimin e statusit në hierarkinë e njësive, lënien jashtë fjalësit të ESH, si edhe evidentimin e lëndës-shtesë.*

c). *Burime ndihmëse për informacion janë: enciklopeditë krahinore dhe tematike (të fushave); fjalorët enciklopedikë të specialiteteve (onomastikë, toponomastikë etj.); leksikonët enciklopedikë sipas profesioneve; korpuset e leksikut të gjuhës shqipe (emërtimet e përveçme dhe termat bazë).*

ç). *Për njësitë enciklopedike jo të përveçme, me kuptim të përgjithshëm (emërtime gjuhësisht të ndërkombëtarizuara dhe të tretura në shqip), përzgjedhja bëhet duke vlerësuar e krahasuar pranimin e tyre në enciklopedi të vendeve fqinje, me ngjashmëri historike dhe numerike në popullsi e hapësirë.*

d). *Redaksitë e të tre niveleve (qendër, vend, fushë), sipas kompetencës që u njihet rregullorja, mund të mbështeten për marrje informacioni edhe në enciklopeditë e numerizuara; si dhe në fjalorët enciklopedikë të vendeve të tjera, për rastin e personaliteteve shqiptare të promovuar në to.*

dh). *Ndryshimet në fjalësin themelor të ESH (shtim, përzgjedhje) propozohen nga redaksitë e fushave dhe miratohen përfundimisht nga redaksia qendrore, pas diskutimit e marrjes së konfirmimit në redaksinë vendore, në përputhje me nenin 6 pika 4 të rregullores së përbashkët.*

e). *Krahasuar me fjalorët enciklopedikë, ESH përfaqëson një shkallë më të lartë hierarkike në pikëpamjen tipologjike, që shprehet edhe në kalimin prej njësisë zë në njësinë artikull. Paraqitja e njësive enciklopedike në ESH në formatin zë në këto botime nuk është kusht i mjaftueshëm për pranimin si artikull në ESH.*

5. Struktura e artikullit në ESH

a). *Njësia enciklopedike hartohet si tekst me strukturë kompakte dhe përbëhet nga: hyrja a definicioni, shtjellimi i përmbajtjes e përfundimi.*

b). *Teksti i njësisë enciklopedike përfaqëson një tërësi koherente, që lexohet pa shkëputje dhe pa ndarje artificiale. Në artikujt e vegjël kjo strukturë është më e*

ngjeshur, telegrafike, dhe në shumicën e rasteve *nuk është e strukturuar si tek artikujt e mesëm dhe të mëdhenj.*

c). Artikujt e vegjël si rregull nuk ndahen në paragrafë, ndërsa artikujt e mesëm e të mëdhenj ndahen në dy ose në tre paragrafë sipas strukturës minimale përshkruar më sipër. Ndarja në paragrafë bëhet në funksion të lehtësimit të përdorimit dhe është rezultat i specifikës së përmbajtjes.

ç). Struktura e artikullit enciklopedik është si vijon: *titulli (emërtimi); teksti i strukturuar si më sipër (në rastet e artikujve të mëdhenj dhe monografikë edhe nëntituj, referuar emërtimeve të fushave); citimet plotësuese të brendashkruara në tekst sipas sistemit të njësuar të referencave zgjedhur me këtë dokument; ilustrimet me dicitura shkencore (foto, harta, vizatime, grafikë); një bibliografi minimale të domosdoshme; emrat e autorëve;*

Artikulli në ESH përmban:

a). Të dhëna të përgjithshme *historike-jetësore e kronologjike-kulturore për rrethin e jetës të subjektit/ ngjarjes, duke përfshirë sipas rastit edhe shpjegime për burimin gjuhësor të emërimit (Prizren, Drin, Devoll).*

b). Të dhënat më të rëndësishme të karrierës krijuese e profesionale; të zhvillimit si individualitet, paraqitur në stil telegrafik, me fjalë të kursyera, duke u ndalur posaçërisht në fushën e ekspertizës / kontributit (tek Fan Noli - krijuesi; tek Besim Bokshi - gjuhëtari). Për ngjarjet dhe dukuritë historike të dhënat më të rëndësishme janë: vitet kufitare të zhvillimit, shkalla e përpapjes në vend (lokalizimi), fazat e zhvillimit, shkaqet, protagonistët, sloganet, qëllimet, rezultatet, jehonën brenda dhe jashtë vendit në kohën e zhvillimit dhe më pas.

c). Për personalitetet me veprimtari krijuese-shkencore - veprat dhe kontributet kryesore të tyre, duke veçuar veprat me të cilat identifikohen (Ismail Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*; Ali Podrimja, *Lum Lumi*; Abdurrahim Buza, *Muhaxhirët*).

ç). Vlerësimin publik të figurës në kërkime e studime të mëparshme.

d). Titujt, gradat, çmimet, trofetë dhe mirënjohjet.

dh). Vendi në kontekst të trashëgimisë së fushës.

6. Stili i shkrimit enciklopedik në ESH

Në pikëpamje të stilit të të shkruarit, *kalimi nga zëri tek artikulli përbën ndryshim cilësor krahasuar me traditën e shkrimeve enciklopedike. Seleksionimi prej zërave të fjalorëve enciklopedikë ekzistues dhe shtimi i njësive të reja jashtë tyre përbën*

jo shtim të thjeshtë numerik, por ndreqje raportesh në dobi të njësive që kanë natyrë përgjithësuese për identitetin, historinë, kulturën e dukuritë kombëtare.

Të dhëna të përgjithshme për shkrimin enciklopedik janë:

a). Kriteret teknike-stilistikore të artikullit në ESH kanë për qëllim të *njësojnë kompozicionin e shkrimit, mënyrën e administrimit të të dhënave; si dhe përshtatjen e tekstit në përputhje me madhësinë e artikullit.*

b). Shkrimi enciklopedik është tekst në prozë, në *shqipen standarde*, pa arkaizma, dialektizma apo idioma, përveç rastit kur kanë të bëjnë domosdoshmërisht me identifikimin historik, *gjuhësor e kulturor* të personave ose janë pjesë e burimeve të cituara në formën e referencës dhe njihen në përdorim gjerësisht nga folësit/përdoruesit.

c). Shkrimi enciklopedik është *tekst neutral*, që shkruhet për të informuar e shpjeguar, për të bërë të njohur trashëgiminë shqiptare dhe jo për të shprehur qëndrime autoriale ose emocione. Thjeshtësia dhe saktësia janë veçoritë themelore dhe përparësitë e këtij lloji të shkrimit.

ç). Artikulli në ESH shpjegon nocionet ose jep të dhëna për ndonjë person, ngjarje, dukuri apo institucion. Në shkrimin enciklopedik nuk përdoret *ligjërim i figurshëm*. Profilet e personaliteteve dhe rëndësia e ngjarjeve paraqiten pa metafora, simbole dhe figura të tjera stilistike. Shkrimi enciklopedik nuk ka për qëllim bukurinë e shkrimit.

d). Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave dhe vërtetueshmërinë shkencore të tekstit të njësive enciklopedike është e autorit të artikullit, duke përfshirë citimet, referencat dhe bibliografinë, të cilat nuk janë të vetëmjaftueshme për të garantuar vërtetësinë e fakteve. Pjesë e përgjegjësisë për saktësinë shkencore të lëndës enciklopedike që propozohet për botim është dhe autoriteti i redaktorëve dhe redaksive.

dh). Për hartimin e njësive enciklopedike përdoret *shkrim narrativ*, me karakter informues, që synon konfirmimin e gjendjes së dijes deri më sot. ESH stabilizon *dijen në gjendjen e arritur*, pa synuar arritje shkencore për herë të parë (premierë).

e). Njësitë enciklopedike hartohen në *stil pohues*, pa hipoteza autoriale të shkruesve. Gjuhësisht artikulli shkruhet në të tashmen gramatikore, pa modalitete (dëshirore, kushtore, mundësie etj.). Shkrimi enciklopedik gjithnjë nis në të tashmen konstatuese (Ismail Qemali është themelues i shtetit shqiptar; Azem Shkreli është shkrimtar shqiptar që i përket brezit të modernizimit të letërsisë në Kosovë) dhe pas kësaj mund të rivendoset në kohë të shkuar (e kryer e thjeshtë). Në artikullin enciklopedik nuk ka paranteza dhe digresione, epitete dhe cilësime të përgjithshme (i jashtëzakonshëm, i shkëlqyer, madhështor).

ë). Antitezat në lidhje me burimin gjenetik të popullit shqiptar, përhapjen historike e gjeografike, vazhdimësinë, tipologjinë specifike të gjuhës, rolin në ngjarje historike etj. vlerësohen duke paraqitur e theksuar posaçërisht fakte e argumente për të kundërtën, në dobi të së vërtetës shkencore.

7. Emërtimet e përveçme në forma gjuhësore të ndryshme në ESH

a). Kur emrat e përveçëm (vende, ngjarje, personalitete) kanë disa forma gjuhësore të shkruari dhe njohjeje brenda dhe jashtë vendit: *historike-tradicionale; popullore-zyrtare; homoglotte-aloglotte; kombëtare-ndërkombëtare, forma referenciale do të jetë si në gjuhën shqipe sot. Në vijim shenjohe forma në gjuhën e tjetrit (Aulon, Avilon, Valona) dhe, nëse ka, edhe forma ndërkombëtare.*

b). Emërtimet e njerëzve dhe vendeve që vijnë prej periudhës së parashqipes: ilirisht dhe nga gjuhë të tjera (Aos, Thyamis, Scupi, Astibos, Epidamnos, Scodra, Scerdilajd, Albanopolis, Bylis, Ulpiana, Naissus) shenjohe si artikuj më vete dhe shtjellohen në rrafsh etimologjik, historik dhe gjeografik.

c). Për figurat historike me forma të shkruari të emrave të tyre në disa gjuhë të huaja, këto shenjohe duke nisur fillimisht prej formës më të përgjithësuar, pastaj tek forma që përdor autori vetë (Girolamo de Rada) dhe së fundmi tek përdorimi në gjuhën ku ka kontributin kryesor.

ç). Në rastin e heteronimeve e pseudonimeve, këto shenjohe në krye si titull artikulli vetëm nëse njohja publike është më e madhe përmes tyre (Lekë Gruda, Lumo Skëndo, Migjeni, Hyskë Borobojka).

8. Hierarkia midis artikujve në ESH

a). Emërtimet e përveçme që kanë të bëjnë me identifikim epokash dhe me rol përcaktues për përrurimin dhe njohjen ndërkombëtare të identitetit shqiptar (Iliria, ilirët, albanët, Arbëria, Shqipëria, shqiptarët, gjuha shqipe, Dardania, Kosova, Gjergj Kastrioti, Ismail Kadare, Nënë Tereza) paraqiten me artikuj monografikë.

b). Emërtimet e përveçme me rëndësi historike-kombëtare paraqiten me artikuj të mëdhenj (Beteja e Fushë-Kosovës, Besëlidhja e Lezhës, Konferenca e Rambujesë, Muzakajt, Dukagjinët, Pjetër Bogdani, Ali pashë Tepelena, Jeronim de Rada, Naim Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, lufta e Vlorës).

c). Emërtimet e përveçme me rëndësi rajonale paraqiten me artikuj të mesëm (Haki Stërmilli, Helenau, Sheh Mala i Rahovecit).

ç). Emërtimet lokale paraqiten me artikuj të vegjël.

d). Emërtimet për grupime protagonistësh dhe ngjarjesh paraqiten me artikuj përmbledhës (publicistët e viteve 1930, këngët antifashiste).

dh). Përcaktimi i hierarkisë së artikullit bëhet rast pas rasti, duke iu referuar parimit të analogjisë dhe krahasimit ndaj rasteve të pranuara nga redaksia vendore dhe ajo qendrore.

Një mundësi shkallëzimi mund të ishte si në vijim:

Nr.	Fusha	Artikull i madh	Artikull i mesëm	Artikull i vogël
1.	Arkeologji	Durrachion	Dagnum	Sarda
2.	Histori	Lidhja Shqiptare e Prizrenit	Lidhja e Pejës	Lidhja e Dytë e Prizrenit
3.	Letërsi	Jeronim de Rada	Azem Shkreli	Josif Bageri
4.	Gjuhësi	Eqrem Çabej	Gjergj Pekmezi	Lirak Dodbiba
5.	Hidroenergjetikë	Petrit Radovicka	Emin Mysliu	Ismail Ahmeti
6.	Mjekësi	Selaudin Bekteshi	Panajot Boga	Jani Basho
7.	Hidronime	Drini Semani	Ishmi	Rapuni
8.	Oronime	Sharri Tomorri	Vigu	Bureto
9.	Fusha	Fusha e Kosovës	Fusha e Korçës	Domosdova
10.	Miniera	Stari Tërgu	Bulqiza	Memaliaj
11.	Piktorë	Ibrahim Kodra, Gjelo Gjoka	Sali Shijaku	Danish Jukniu
12.	Kompozitorë	Çesk Zadeja	Limos Dizdari	Thoma Nasi

Në të njëjtë mënyrë:

Kombëtare (artikull i madh)	Rajonale (artikull i mesëm)	Lokale (artikull i vogël)	Dukuri (artikull përmbledhës)
Vlora	Kanina, Narta, Selenica	Zvërneci	
Balshajt, Qyprillinjtë	Skurajt	Spanët	Familje patronimike
Ismail Kadare	Naum Prifti	Milto S. Gurra	Brezi 1930

9.1. Kriteria të përfshirjes në ESH (personalitetet)

a). Për personalitetet, *suksesi profesional dhe karriera e vlerësuar publikisht në shërbime qytetare* përbëjnë një kriter vëmendjeje për vlerësim. Ky kriter duhet të gjejë mbështetje në argumente ndihmëse.

b). *Shenjat publike vlerësuese* për personalitete, ngjarje apo dukuri (mirënjohjet zyrtare publike, dekoratat dhe medaljet, titujt e nderit, diplomat, trofetë dhe çmimet) *përbëjnë kriteret pranuese* në ESH. Këto kriteret nuk kanë karakter të vetëmjaftueshëm.

c). Redaksia vendore e Tiranës dhe redaksia vendore e Prishtinës *merren vesh për njësimin ose përafrimin e shenjave të vlerësimit publik*.

ç). Për dukuritë dhe personalitetet që janë kthyer ndërkaq në trashëgimi të gjithëpranuar shenjat publike të nderimit apo suksesit (që i takojnë periudhës prej vitit 1912 e në vijim) *nuk janë të domosdoshme*. Mirënjohjet dhe vlerësimet për merita krijuese jashtë vendit çmohen si kriter pranues në ESH.

d). Kriteret e përfshirjes për rastin e personaliteteve formulohen *gramatikalisht me karakter pohues*. Fjalët mohuese (nuk, mos etj.) për të treguar diçka që s'ka ndodhur (nuk mori pjesë në mbledhjen ..., nuk u rreshtua në ...) dhe formulime të tjera të ngjashme me karakter përjashtues a ndalues nuk pajtohen me këtë stil.

dh). ESH ka karakter *integrues*. Personalitetet, ngjarjet dhe dukuritë që kanë vend në botime enciklopedike të mëparshme *përzgjidhen në përputhje me kriterin e përfaqësimit*. Figurat e munguara në këto botime për shkak të kufizimeve ideologjike, fetare, historike përfshihen në ESH sipas kriterit të vërtetësisë, përmes paraqitjes kronologjike të fakteve të jetës dhe veprimtarisë së tyre.

e). Secila nga redaksitë e fushave përcakton *kritere ndihmëse orientuese për pranim, specifike për çdo fushë*, që shërbejnë si referenca për përzgjedhje.

Disa shembuj të mundshëm:

Fusha	Shenjë publike, sukcesi, karriere (rregull pranimi)
Sport	Rekordmenët ndërkombëtarë, europianë, kombëtarë
Shkencë	Akademikët, profesorët, themeluesit e një dije brenda vendit, dijetarët e shquar pa tituj e mirënjohje
Arte	Mbajtësit e titujve të lartë të nderit si aktorë, piktorë, regjisorë; fituesit e konkurseve kombëtare
Muzikë	Themeluesit e një lloji/nënllloji (Preng Jakova), të parët kronologjikisht në një zhvillim (Lorenc Antoni)
Diplomaci	Ministra, ambasadorë, me emrin e të cilëve lidhet një ngjarje e rëndësishme për shqiptarët
Histori, personalitete historike	<i>Protagonistët e një ngjarjeje, që shërben edhe si figurë identifikuese për të</i> (Selam Musai për luftën e Vlorës, për shembull; Jasharajt për qendresën shqiptare në Kosovë) Figurat publike me rol të rëndësishëm në ngjarje kyçe të historisë së popullit shqiptar (<i>shpallja e Pavarësisë, themelimi i parlamentarizmit shqiptar, mbrojtja e çështjes shqiptare jashtë kufijve të 1913-ës, përfaqësimi në konferenca të paqes, lufta antifashiste, çlirimi i Kosovës, pavarësia e shtetformimi i saj</i>); personalitete që kryer funksione të larta shtetërore-qeverisëse (presidentë, kryeministra, ministra, titullarë institucionesh) dhe kanë luajtur rol në zhvillimet e vendit

Përfashtime nga kriteret e shenjave publike bëhen:

a). Rasti i personaliteteve të shquar bashkëkohës, me veprimtari krijuese e qytetare të gjithëpranuar, për të cilët ka konsensus në publik.

b). Personalitetet që kanë fituar trofe të rëndësishme ndërkombëtare (Rita Ora, Dua Lipa, Ermonela Jaho).

c). Personalitete që *nuk plotësojnë disa kritere formale* (grada shencore, tituj nderi), por kanë lënë gjurmë në trashëgiminë shqiptare (S. Riza, F. Agalliu, Dh. Qiriazi);

ç). Protagonistë të ngjarjeve që përbëjnë kthesa të mëdha në jetën e popullit shqiptar (pjesëmarrës aktivë në to).

9.2. Kriteria të përfshirjes në ESH (emërtime vendesh)

a). Emërtimet e përveçme për vendbanime, zona, njësi krahinore, shkallëzohen në përputhje me ndarjen etnokrahinore tradicionale të popullit shqiptar (në Shqipëri sipas Rrok Zojzit dhe në Kosovë sipas Mark Krasniqit).

b). Hierarkitë në ndarjen etnokrahinore *prevalojnë krahasuar me ato sipas ndarjes zyrtare-administrative* (Dibër ndaj Peshkopi, Has ndaj Krumë, Mat ndaj Burrel, Kurvelesh ndaj Tepelenë, Mat ndaj Burrel, Mirditë ndaj Rrëshen, Lumë ndaj Kukës, Devoll ndaj Bilisht, Kurbin ndaj Laç).

c). Toponimet që lidhen me ngjarje, zhvillime apo personalitete historike përfaqësohen në ESH pavarësisht kriterit të mësipërm (Novobërdë, Çidhën, Shkrel, Selenicë, Tanushë, Torvioll, Gazi-Mestan, Greçë). Në këtë përfaqësim përfilllet hierarkia zyrtare qytet-qytezë-fshat-lagje.

ç). Njësitë dhe qendrat administrative përfaqësohen në ESH (me përfaqësim të përshkallëzuar sipas hierarkisë së artikujve: qarqe, bashki, komuna).

d). Të gjitha llojet dhe format e arkeonimeve përfshihen në ESH (Ulpiana, Pelagonia, Svetigradi, Scampinus, Via Egnatia, Via Publica, Emathia, Issamnus).

9.3. Kriteria të përfshirjes në ESH (ngjarje, dukuri, zhvillime)

a). Ngjarje me ndikim në jetën politike-sociale dhe gjeopolitike të gjithë shqiptarëve (Rilindja Kombëtare, Shpallja e Pavarësisë, kryengritja e qershorit 1924, vendosja e monarkisë, fitorja antifashiste, dalja nga Traktati i Varshavës; lufta çlirimtare në Kosovë, Pavarësia e Kosovës, vendosja e pluralizmit në Shqipëri).

b). Ngjarje me ndikim të drejtpërdrejtë a të tërthortë në jetën kombëtare të shqiptarëve (Memorandumi i Greçës, Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë, Kongresi i Lushnjes, Paqja e Versajës, Kongresi i Manastirit, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës).

c). Ngjarje me ndikim rajonal-sekondar në historinë e zhvillimeve shqiptare (Kongresi i dytë i Manastirit, akademia e ipeshkvinjve, Komisia Letrare e Shkodrës).

ç). Ngjarje të kushtëzuara prej rrethanash kombëtare e ndërkombëtare (krahina autonome e Korçës, shteti ndërkombëtar i Shkodrës, republika e Mirditës).

d). Dukuri me ndikim në jetën shqiptare në tërësi (*ateizmi, ideologjizimi*).

10. Personalitetet joshqiptare në ESH

a). Personalitetet joshqiptare me kontribute në shkencë dhe politikë kanë vend në ESH *varësisht prej rolit që kanë pasur në jetën e shqiptarëve*.

Presidentë të SHBA	W. Wilson, T. Roosevelt, B. Clinton
Kryeministra	M. Ataturk, W. Churchill, Tony Blair, Çu Enlai
Ministra të jashtëm	M. Albright, T. Pangalos
Shkrimtarë, zbulues	Antonio Gramshi, Robert de Niro, Ferid Murati, dinastia Köprülü, Mehmet Ali pasha

b). Emrat e personaliteteve joshqiptare të pranuar në ESH sipas kriterit më sipër *në krye shkruhen si në shqiptim* (Toni Bler, Fransua Miteran, Margaret Theçer) dhe *në kllapa si në origjinal* (Tony Blair, François Miterrand, Margaret Thatcher), vetëm në shfaqjen e parë.

c). ESH ofron informacion përmes njësive enciklopedike të niveleve të ndryshme për personalitetet politike, kulturore e historike me rol të spikatur në vende të tjera, *me prejardhje shqiptare* (vëllezërit Manaki, vëllezërit Belushi).

ç). Përfshihen në ESH ngjarjet në të cilat është vendosur edhe për shqiptarët (*paqja e Rambujesë, armëpushimi i Kumanovës, marrëveshja ad interim accord of Badinter commission*). Përfshihen dhe rastet kur vendimet kanë qenë në dëm të tyre ose nuk kanë pasur përfaqësim të shqiptarëve (*Marrëveshja e Lozanës, Akti Final i Helsinkit, konferencat panballkanike në vitet 1930*).

d). *Albanologët, ballkanologët, bizantologët, orientalistët, latinistët, romanistët, sllavistët që u kanë kushtuar shqiptarëve vend të rëndësishëm në kërkimet e tyre, përbëjnë artikuj enciklopedikë më vete.*

11. Sistemi i referencave në ESH

a). *Sistemi i referencave do të jetë i njësuar, sipas standardit ndërkombëtar Chicago referencing system, qoftë në citim, qoftë në bibliografi. Modele për lehtësi përdorimi në zbatim bashkëngjitur: Enciclopedia Trecahi dhe Enciclopedia of Cold War*). Për vetë karakterin enciklopedik, që nuk synon shkencën e mirëfilltë por

standardizimin e dijes në gjendjen e sotme, në artikuj do të citohen vetëm tituj të domosdoshëm (për shembull, për Gjergj Kastriotin: Barleti, Fan Noli, Athanas Gega, Kristo Frashëri, Pëllumb Xhufi).

b). Citimet në ESH janë të brendashkruara (Barleti, 1504:18). Titujt që përmenden brendashkruar artikullit renditen në fund alfabetikisht. Një bibliografi minimale prej 2-3 titujsh shenjohe edhe kur nuk ka citime të brendashkruara. Numri i titujve të shenjuar në bibliografinë e përzgjedhur është 5-7 për artikujt e gjatë, 3-5 për artikujt e mesëm dhe 1-3 për artikujt e vegjël e përmbledhës. Në faqesje për bibliografinë zbatohen të njëjtat shenja grafematike, *dy shkallë minus atyre të tekstit të artikullit*. Kur nga i njëjti autor citohen dy ose më shumë vepra, e para shenjohe me nr. 1 dhe veprat citohen të numërtuara sipas kronologjisë. Kur citohet një artikull i botuar në një revistë apo përmbledhës, shenjohe emri i periodikut, nr. progresiv dhe viti i botimit, si dhe faqet kufizuese.

Disa shembuj:

Në citim	Në bibliografi
Xhufi, 2016:137	P. Xhufi, <i>Arbërit e Jonit, Delvina e Janina në shek. XV-XVII</i> , bot. Onufri, Tiranë 2016.
Ducellier, 1987:15	Alain Ducellier, <i>L'Albanie de l'entre Byzance et Venise, X^e-XV^e siècles</i> , Londrës 1987
Çabej-1, 1936:29	Eqrem Çabej, <i>Elemente të gjuhësisë dhe literaturës shqipe</i> , 1936.
Rugova, 1978:17	Ibrahim Rugova, <i>Kah teoria</i> , 1978

12. Referimet brenda ESH

Referencat brenda ESH përdoren sipas sistemit të njësuar përmendur më sipër për të ndërlidhur lëndën enciklopedike që përmbajnë artikujt, për të shmangur përsëritjet, për të plotësuar informacionin e për të lehtësuar leximin.

a). Referencat e kryqëzuara (crossreference) përdoren në formatim numerik (me ngjyrosje të fjalës-lidhje dhe funksionalizim të saj).

b). Referimi në *term/fjalës* bëhet vetëm në rastet kur *emërtimi është i dyfishtë* (Karadak - Mali i Zi; Mitrush Kuteli - Dhimitër Pasko; Sad Nokshiq - Esad Mekuli; Sarda - Shurdhahu; Gent Arbana - Ismail Kadare).

c). Kur *fjala-çelës* e përdorur për t'u adresuar në një njësi tjetër është e *pareferueshme elektronikisht*, përdoret shenjimi me korsiv dhe vëmendja shih në kllapa.

ç). Referenca të kryqëzuara bëhen vetëm në artikullin e madh e të mesëm, kur kanë lidhje të gjerë tematike dhe kur *kryqëzimet e brendshme referenciale (crossreference)* shkurtojnë tekstin (p.sh., në fund të artikullit për Pashkun mund të shtohet shenjimi shih edhe: *Vox clamantis in desertio*).

d). Treguesi emëror në fund të çdo vëllimi përmban tri pjesë: emrat-terma (fjalësi, vetëm me emrat dhe emërtimet e përveçme); emra të tjerë që përmenden në lëndën enciklopedike; emrat e autorëve.

13. Shkurtesat në ESH

Për të ekonomizuar mjetet gjuhësore të shprehjes e për të shmangur informacionin e tepërt në artikujt enciklopedikë përdoren *shkurtesa*:

a). Shkurtesat që përdoren më shpesh në artikujt enciklopedikë përdoren sipas formës së tyre në *Fjalorin drejtshkrimor të shqipes* ose në vendimet e *Këshillit Ndërakademik Gjuhësor*.

b). Shkurtesat e reja të krijuara nga redaksitë e fushave bëhen të njohura në redaksinë vendore, që bën njësimin paraprak. Njësimin përfundimtar e bën redaksia qendrore.

c). Përveç rasteve kur është e pamundshme të përdoret *referimi elektronik, me ngjyrosje blu të fjalës-lidhje*, shkurtesa shih e përdorur në fjalorët enciklopedikë nuk është e pranueshme.

ç). Shkurtesat përbëjnë një rubrikë më vete në fund të artikullit vetëm kur përdoren për herë të parë. Në të gjitha rastet e tjera shkurtesat shpjegohen në fund të vëllimit.

d). Shkurtesat në referenca dhe në bibliografi rregullohen sipas sistemit të referimit zgjedhur me këtë dokument.

dh). Emrat e njerëzve shkruhen në formë të shkurtuar vetëm në formën *nistore e emrit plus mbiemrin e plotë*. Kjo formë shkurtese është e detyrueshme edhe për rastet e personaliteteve të shquara (Kadare, Rugova, Pashku), përveç rasteve

kur heteronimi / emri i artit është njëgjymtyrësh (Migjeni, Helenau) ose kur njihen historikisht vetëm me emër njëpjesësh (Genti, Teuta, Migjeni etj.).

14. Terminologjia ndërkombëtare në ESH

- a). ESH është promovuese e trashëgimisë shqiptare, por edhe e asaj pjese të trashëgimisë botërore që është albanizuar gjuhësisht dhe në koncept.
- b). Raporti midis emërtimeve të përveçme (njerëz, vende, ngjarje) dhe emërtimeve të përgjithshme (terma etj.) synohet 4 me 1.
- c). Terminologjia e albanizuar gjuhësisht pavarësisht burimit (*belgjik, mauzer, martinë; volt, njuton, farad, grej, faradej*) paraqitet më vete bashkë me burimin historik-gjuhësor që lidhet me emra të përveçëm.
- ç). Termat bazë të shkencave, që janë ndërkombëtarizuar dhe janë bërë pjesë e marrëveshjes së komunikimit (emërtimet e disiplinave, p.sh.).
- d). Termat që lidhen me pasuritë e vendit (kromitet, ferritet, albanitet). Nacionet e përgjithshme të shkencave dhe dukurive të vendeve të tjera pasqyrohen për aq sa janë të lidhura me botën shqiptare.

15. Modelet e artikujve në ESH

- a). Redaksia qendrore harton e miraton *modelet e artikujve* sipas hierarkisë dhe përshkrimit në dokumentin e miratuar në Prishtinë në mbledhjen e saj të datës 06.04.2023.
- b). Modelet e artikujve hartohen sipas përgjegjësive të shkallëzuara të redaksive dhe ndjekin këto shkallë: *propozimet* vijnë nga redaksitë e fushave; *konfirmimet* bëhen në redaksitë vendore; vendimet merren në redaksinë qendrore, e cila gjithashtu zgjidh edhe *problemet* që mund të rezultojnë në raportet ndër-redaksionale.

Kryeredaktori
Akademik Skënder Gjinushi



Zëvendëskryeredaktori
Akademik Mehmet Kraja





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
REDAKSIA QENDRORE**

Nr. 605 Prot

Tiranë, më 08/04/2026

UDHËZUES

për disa saktësime të posaçme mbi statusin artikullit përmbledhës, madhësitë e artikujve për personalitetet si dhe teknikaliteteve redaksionale për përgatitjen e artikujve enciklopedikë

I

SAKTËSIMETË TË POSAÇME PËR REDAKSITË

Artikulli përmbledhës

- a) Karakteri *përmbledhës* i artikullit lidhet me natyrën e dukurisë a të ngjarjes që trajton, e cila, në vetvete, mund të përmbledhë disa nënngjarje që burojnë prej saj apo të lidhura me të ose me personalitete që kanë kontribuar në të;
- b) Artikulli përmbledhës, si rregull, është *i mesëm*;
- c) Në raste të veçanta, artikulli përmbledhës mund të jetë edhe *i vogël* apo *i madh*, kur dukuria e trajtuar është më e kufizuar apo më e gjerë.
- d) Në secilin rast kur artikulli është përmbledhës, përkrah duhet shënuar v për *i vogël*, m për *i mesëm* dhe M për *i madh*.
- e) Konceptet e përgjithshme mund të jenë artikuj përmbledhës *vetëm* në ato raste kur vendosen brenda një konteksti lokal apo kombëtar. Për shembull, *Diaspora* si koncept duhet të jetë artikull *i vogël*. *Diaspora shqiptare në Evropë* është artikull përmbledhës.
- f) Artikulli përmbledhës, si rregull, ka së paku dy autorë.
- g) Artikulli përmbledhës me shtrirje mbarëshqiptare domosdoshmërisht ka së paku dy autorë.

Artikujt për personalitetet

- a) Artikujt për personalitetet, si rregull, janë artikuj *të vegjël*;
- b) Artikulli për një personalitet mund të jetë *i mesëm* kur
 - I. Është e nevojshme të shtjellohet edhe kontributi i veçantë i veprës së tij në fushën/fushat përkatëse, sidomos në albanologji, krahas biografisë dhe veprimtarisë kryesore të personalitetit;

II. Personaliteti ka kontribut të dalluar në disa fuasha dhe/ose drejtime të ndryshme të jetës shoqërore.

- c) Artikulli për një personalitet mund të jetë *i madh* në raste shumë të veçanta, kur kontributi është i spikatur dhe me ndikim domethënës. Përcaktimi i këtyre artikujve është kompetencë e Redaksisë Qendrore.

Artikujt për figurat historike

- a) Artikujt për figurat historike, si rregull, janë artikuj *të vegjël*;
- b) Artikulli për një figurë historike mund të jetë *i mesëm* në ato raste kur veprimtaria e atij/asaj që trajtohet është *i/e* gjerë dhe roli që ka luajtur ka qenë kryesor në ngjarjet a veprimtaritë respektive.
- d) Artikulli për një figurë historike mund të jetë *i madh* në raste shumë të veçanta, kur kontributi është i spikatur dhe me ndikim domethënës. Përcaktimi i këtyre artikujve është kompetencë e Redaksisë Qendrore.

II

UDHËZUESI TEKNIK DHE REDAKSIONAL PËR PËRGATITJEN E ARTIKUJVE ENCIKLOPEDIKË

Ky udhëzues synon të njësojë teknikisht, në shkrim e në shtypshkrim, mënyrën e përgatitjes së artikujve që do të botohen në *Enciklopedinë Shqiptare* (ESh).

Ky njësim përfshin: titullimin e artikullit (si një emërtim i vetëmjaftueshëm, me minimumin e mjeteve të shprehjes, duke përfshirë rendin e fjalëve përbërëse); formatimin teknik të tekstit të artikullit; nëntitujt në artikull (në rastet kur artikulli është i ndarë në nënpjesë); mënyrën e citimit të monografive, artikujve dhe burimeve; referencat e brendashkruara (*crossreferences*); bibliografinë e domosdoshme (në fund të artikullit); ilustrimet; shkurtesat e mundshme të titujve të artikujve në tekst (emra të personaliteteve, subjekteve) dhe përveçimeve të tjera (njësi matëse, shenja e simbole matematike); shkurtesat për të dhëna gjuhësore që përsëriten rregullisht; Emrin/emrat e autorit / autorëve realizues të artikujve.

I. Njësimet të përgjithshme:

Udhëzuesi mbështetet në kriteret themelore për hartimin e ESh dhe në aktet e tjera ndihmëse, të miratuara nga RQ (rregullore, rekomandime); në parimet e drejtshkrimit të shqipes dhe në traditën e botimeve enciklopedike shqiptare e botërore. Njësimi mban në vlerësim si praktikë *artikujt-model* të hartuar e miratuar nga RQ, që i bashkëmbyllën këtij udhëzimi.

Në të gjithë përbërësit e vet (tekst, referime, ilustrime shoqëruese), artikulli në ESh respekton legjislacionin vendës dhe ndërkombëtar për të drejtat e autorit dhe pronësinë intelektuale.

1. Struktura e artikujve, rendi i rubrikave brenda tyre, si dhe kufizimet në numër shenjash, përcaktohen në një *matricë digjitale*, që përgatitet nga specialisti i IT i QBEA dhe miratohet nga bordi i saj, pas verifikimit të pajtueshmërisë me përshkrimin e tyre në kriteret themelore. Limitet që vendosen në *matricë (template)* janë të detyrueshëm.

2. Madhësia e artikujve është përcaktuar në kriteret themelore dhe zbatohet njëjtësisht gjatë hartimit të tyre. Për lehtësimin e punës redaktuese artikujt radhiten në *Times New Roman 12-she* dhe fleta përmban orientimisht 2200 shenja bashkë me hapësira. Lloji i shkronjës dhe madhësitë e saj do të përcaktohen pas marrjes së vendimit për formatin e botimit. Në çdo rast dallimi midis shkronjës së tekstit e shkronjës së bibliografisë është 2 shkallë.

3. Tekset radhiten nga autorët në formatin *Word 6.0*. Redaksia nuk pranon tekste në dorëshkrim apo daktiloshkrim. Çdo artikull dorëzohet i radhitur më vete, brenda *matricës digjitale* që i takon.

II. Titullimi i artikujve për personalitete:

1. Titulli i artikullit për *njësi të përveçme për personalitete* shkruhet sipas rendit *mbiemër + emër*, ndarë me presje dhe me pikë pas emrit. Mbiemri si në pikën 4, kurse emri si në rastin e nëntitujve: **SHKRELI, Azem**. Në të gjitha rastet e përmendjes brenda brenda artikullit të monografik, të gjatë a të mesëm, emri i autorit shenjohe vetëm me nistore, kurse mbiemri i plotë, në rend të drejtë. Për rastet e artikujve të vegjël e përmbledhës emri dhe mbiemri shenjohe vetëm me nistore. Për emrat njëpjesësh të personaliteteve (*mononime*), që njihen historikisht me një emër të vetëm ose me një pseudonim nuk përdoren shkurtime brenda tekstit: **Migjeni, Asdreni**.
2. Kur emri është njëherësh *përveçim i një njësie tjetër* (shkollë, spital, rrugë), dallohet në shkrim me gërmë të vogël bold, kursive: *Petro Nini*, shkollë e mesme në Tiranë; *Bajram Curri*, qytet në veri të Shqipërisë.
3. Për njësitë që shenjojnë personalitete të njohur tradicionalisht me emra letrarë (heteronime, pseudonime, akronime) shërben si titull heteronimi (pseudonim, akronim). Emri i plotë vëhet në kllapa dhe përsëritet si njësi e referuar: **MIGJENI** (Millosh Gjergj Nikolla); **NIKOLLA**, Millosh Gjergj (shih: **MIGJENI**); **COLUMBIA** (shih *Selfixhe Ciu*). Njësitë me referim të brendashkruar në ESh nuk njehen.
4. Në titull emrat e personaliteteve të huaj që kanë kontribuar për shqiptarët (albanologë, diplomatë, politikanë) shkruhen si në gjuhën e burimit dhe në kllapa si në drejtshkrimin e shqipes: **CLINTON, Bill** (**KLINTON, Bill**); **MEYER, Gustav** (**MAJER, Gustav**).
5. Si rregull në titull nuk përdoren alfabetet jolatine. Emrat e përveçëm të personaliteteve të huaja në këto raste shenjohe sipas formës më të njohur ndërkombëtarisht ose me transliterim fonetik, por brenda kllapave mund të shenjohe dhe forma në burim: **DESNICKAJA, Anna** (**ДЕСНИЦКАЯ, Агния Васильевна**).
6. Mbiemrat e dyfishtë në përbërje të titullit të njësisë për personalitete shenjohe të dy sipas drejtshkrimit të shqipes, me vijë bashkuese: **SHIROKA-PULA, Justina**, kryetare e **ASHAK; PULA-BEQIRI, Luljeta**, profesore në Universitetin e Prishtinës.
7. Emrat dhe mbiemrat e personaliteteve arbëreshe, arvanite dhe të lidhur me ngulime të tjera në titull të njësisë; si dhe të albanologëve të huaj, shenjohe sipas traditës në shqipen e sotme, por në çdo rast edhe ndërmjet kllapash, në formën e përdorur nga ata vetë, si në drejtshkrimin e italishtes: **SKIROI, Zef** (**SCHIRÒ, Giuseppe**); **DISTRIA, Dora** (**D'ISTRIA, Dora**).

8. *Nyjet e fisnikërisë*, pjesë e mbiemrit të personalitetit që i dedikohet njësia, vihen të pandashme me mbiemrin: **DE RADA, Jeronim (DE RADA, Girolamo); DE LAMARTINE, Alphonse (DE LAMARTINE, Alphonse).**

9. *Titulatura osmane, ushtarake dhe joushtarake*, ofiqet dhe gradat, që janë bërë pjesë e pandashme e emrit dhe mbiemrit të personalitetit, në titull shenjohen me shkronja të vogla, pas emrit: **TEPELENA, Ali pashë; VLORA, Ismail bej.** *Titulatura osmane, ushtarake dhe fetare, vlerësohet gjuhësisht në kategorinë e emërtimeve të përgjithshme*, me përjashtim të rasteve kur ajo ka zëvendësuar mbiemrin dhe është në trajtë të shquar. Në këtë rast njësia titullohet me strukturën emër plus titull: **HAJREDIN Pasha; BALLABAN Pasha.**

10. Nuk qendrojnë në titull *nofkat, shkurtimet ledhatuese dhe zbunimet*, të përdorura për emra të përveçëm, por këto mund të jepen brenda teksit të artikullit: **AHMETI, Ali** (njihet dhe si **Abaz Gjuka**); **MUHAXHIRI, Qamil** (njihet dhe si **Qamili i Vogël**).

11. Kur *emrat e përveçëm janë tri pjesësh* (për arsye historike-tradicionale) zbatohet renditja sipas parimit historik-traditional: **GJIN BUA SHPATA** (jo **Bua Shpata, Gjini**); **DEDE GJON LULI** (jo **Gjon Luli, Dedë**). Njësoj veprohet në rastet e emrave të klerikëve kur titulli është bërë pjesë e pandashme e emrit: **At Gjergj Fishta, Dom Nikollë Kaçorri, Dom Lush Gjergji** (jo me rend invers).

12. Emrat e *karaktereve letrarë* të përmendur brenda tekstit në njësi të ESh shkruhen në rend të drejtë, të theksuara me italic: *Marash Uci, Xhezairi i Xhikes, Plaka Nicë.*

13. Emrat e autorëve të artikujve shenjohen *në fund të kolonës mbyllëse, me rend të drejtë, emri me nistore dhe mbiemri i plotë, sipas shkallës së autorësisë*, që zgjidhet prej hartuesve para dorëzimit: **S. Hamiti, P. Asllani; A. Pollozhani, M. Petrela.** Kur artikulli hartohet mbështetur në shkrime të botuar prej autorësh të tjerë që nuk janë më në jetë (në FESH dhe në FEK), rendi i parë rezervohet për autorin e mëhershëm: **Dh. S. Shuteriqi, A. Xhiku, A. Leka.** Në fund të çdo vëllimi paraqitet lista e plotë e emrave të autorëve të artikujve, me renditje alfabetike. Shenjohen titujt e gradat shkencore që kanë në kohën e hartimit të tyre dhe disa të dhëna të tjera të shkurtra.

14. Bibliografia njoftohet *në vijimësi, pa kryerresht, me shkronja 8-she*, dhe përmban: *mbiemrin e autorit të cituar, nistoren e emrit, titullin e librit, vendin e shtypjes, botuesin dhe vitin e botimit*, që renditen teknikisht si në platformën e përbashkët të informacionit shkencor *Cobiss.al* dhe *Cobiss.ks*:

Aliu, A., *Kështjella prej hiri e Luan Starovës*, në *Shekulli*, nr. 204, 27 korrik 2006, f. 23; AA, *Luan Starova - akademiku, shkrimtari i shumëgjuhësisë (ligjërata dhe kumtesa kushtuar veprës krijuese e studimore të akademik Luan Starovës në 80-vjetorin e lindjes)*, bot. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2023; *Poeti i raskazhuvaçi akademici - antologjia na poeti i raskazhuvaçi na Akademijata na naukite i umetnostite na Kosovo*, bot. *Makedonska akademija na naukite i umetnostite*, Skopje 2017.

Për burimet arkivore zbatohet ky rend: emri i fondit (koleksionit), viti, dosja dhe fleta. Burimet nga arkiva të huaj citohen *sipas sinjaturës zyrtare të verifikueshme* në burim:

AQSH, F. 243, V. 1832, D. 207, fl. 43^v; HHStPA (Historic Archive of the Austro-Hungarian Monarchy). Një burim arkivor pa tregues të plotë referimi nuk është i pranueshëm nga redaksia.

15. Titujt e veprave letrare dhe artistike, kur përbëjnë emërtim njësie, shenjohe me shkronja të mëdha kapitale. Kur janë në përbërje të përshkrimit të një njësie tjetër shenjohe me shkronja kursive: *Bagëti e Bujqësia, Kânga e vërrinit, Lum Lumi, Pallati i ëndrrave, Lumi i vdekur, Vargjet e lira, Vepra e Bogdanit.*

16. Emërtimet e përveçme që shenjojnë subjekte të shtypit dhe të mjeteve të tjera të informacionit (radio, televizione, rrjete digjitale), kur shkruhen sipas burimit autorial (parimit historik): *Fjamuri i Arbërit, Shëjzat - Le Pleiades, Zani i Naltë, I fonit tis Albanias, Përlindja e Shqipëniës.* Mjete të tjera mbicilësuese (theksim, thonjëza, nënvizim) nuk përdoren. Kur i njëjti emërtim është përdorur disa herë rendi përcaktohet sipas kronologjisë dhe pas titullit vihen në kllapa vitet kufizuese: *Drita* (1901); *Drita* (1911); *Drita* (1920); *Drita* (1936); *Drita* (1951). Në të njëjtën mënyrë renditen kllapa do të vihet data e fillimit edhe për shoqëri, institucione etj. që kanë të njëjtin emërtim, por që u përkasin periudhave të ndryshme të kohës.

III. Emërtimet e vendeve në titullin e artikullit:

1. Titujt e njësive për emërtime të përveçme të grupimit toponime, hidronime, oronime, arkeonime, ekzonime, shenjohe me shkronjë të madhe 12-she, të gjitha nistore të zgjeruara dhe në trajtë të shquar. Nuk përdoret vijë ndarëse për të dalluar temën e fjalës nga formanti: **POLLOGU, MARTANESHI, ZADRIMA, DEVOLLI, LABËRIA, VJOSA, SHKUMBINI, CEMI, SHARRI, TOMORRI.**

2. Nuk përdoren ndajshimet për emërtimet e përbëra dypjesëshe, përveç rasteve kur gjuhësisht emërtimi ka strukturë të brendshme togfjalëshi: **Drini (jo lumi Drin),** por **Lumi i Vlorës; Drenica, por Rrafshi i Dukagjinit.**

3. Përveçimet me strukturë emër plus mbiemër shenjohe si titull i njësuar: **Guri i Bardhë, Malësia e Madhe, Maja e Zezë, Drini i Bardhë, Fusha e Kuqe, Dropulli i Poshtëm, Mali i Zi, Guri i Kamjes, Mali i Gjerë, Liqeni i Shkodrës.**

4. Në titujt e emërtimeve të përveçme dypjesëshe zbatohet rendi që përdoret në ligjërim, jo rendi i anasjelltë: **Kalaja e Prizrenit (jo e Prizrenit kalaja), Shpella e Pëllumbave (jo e Pëllumbave Shpella), Qafa e Gjarprit (jo e Gjarprit Qafa);** kështu dhe: **Leqet e Hotit, Bishti i Pallës, Ura e Dragotit, Gryka e Kaçanikut.**

5. Në titujt të makrotoponimeve (kur është e mundur edhe të mediatoponimeve), menjëherë pas përcaktimit, shenjohe etimologjia ose forma më e hershme e njohjes në burime gjuhësore, kronika, harta a shkrime të tjera, pa shtjellime arsyetuese:

PRIZRENI, qytet në Kosovë. Në hershmëri njihet si **Theranda** (E. Hamp). **SHARRI**, mal në verilindje të Shqipërisë. Në antikitet njihet me emrin **SCARDUS** (E. Çabej).

6. Titujt e njësive që u referohen makrotoponimeve historike shenjohen në krye në formën e sotme dhe ndërmjet kllapash edhe në formën historike dhe në gjuhën fqinje përkatëse me shkronja jokapitale: **KOSTURI** (Kastoriá); **MRKOVIĆI** (Mërkoviqi, fshat i banuar nga shqiptarët në Mal të Zi); **SHKUPI** (Skoplje).

7. Për titullimin e njësive për emërvende të banuara nga shqiptarët në ngulime historike përpara vihet forma e shqiptimit prej tyre dhe midis kllapash forma tjetër (italisht, greqisht etj. - këto me transkriptim latin): **KUNDISA** (Contessa Entellina); **QAFI** (Kiafa); **MANDRICA** (Mandritsa); **QANA** (Piana dei Albanesi).

IV. Emërtimet e subjekteve shtetërore në titull:

1. Emërtimet e subjekteve shtetërore-administrative të përveçme, me kuptim gjuhësisht tërësor, që kanë vepruar e veprojnë në hapësirën historike dhe aktuale shqiptare, në titull të njësisë, shkruhen me germa të mëdha kapitale të zgjeruara: **QEVERIA E PËRKOHSHME E SHQIPËRISË** (1912-1914); **KRAHINA SOCIALISTE AUTONOME E KOSOVËS** (1974-1989); **MUZEU HISTORIK KOMBËTAR**; **BANKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË**; **TEATRI KOMBËTAR**.

2. Emërtimet e institucioneve të reja, të krijuara gjatë dekadave të fundme, që nuk janë unike në llojin e tyre, shkruhen me shkronjë të madhe për analogji me rregulla të drejtshkrimit për raste të tjera të ngjashme.

3. Nuk shkruhen me germë të madhe fjalët përbërëse të një ndajshtimi në gjedhen *emër i përgjithshëm + emër i përveçëm*: **ansambli Shota, shkolla Petro Nini; spitali Shefqet Ndoroqi; liceu Jordan Misja**.

4. Shkurtesat brenda tekstit për emërtimet e titujve të personaliteteve dhe subjekteve të tjera (emra vendesh, institucionesh) zbatohen si në listën bashkëmbyllur.

5. Shkurtesat brenda tekstit për kategorizime gramatikore e teknike bëhen sipas listës bashkëmbyllur.

6. Shkurtesat përdoren të ngurta (të tronkuara), pa eptim (lakim): **ATSH**, jo **ATSH-ja**; **ASHAK**, jo **ASHAK-u**; **Art-Club**, shoqatë kulturore-artistike në Mal të Zi.

V. Ilustrimet:

1. Ilustrimet shoqërojnë përmbajtjen e artikujve për të shtuar informacionin historik e kulturor dhe për të lehtësuar leximin e tyre. Ilustrimet janë funksionale dhe pranohen kur shtojnë informacion pamor më shumë se teksti.

2. Ilustrimet nuk mund të zënë më shumë se një të tretën e vëllimit të artikullit. Përgjegjësia për origjinalitetin dhe burimësinë parashikohen në kontratën me autorët. Autori i tekstit mund të jetë vetë realizues i ilustrimeve (dizenjo, skema, ekuacione).

3. Numri i ilustrimeve propozohet jo më vonë se një muaj pas lidhjes së kontratës, nga autorët e artikujve sipas hierarkisë së tyre (përpjesëtimisht me madhësinë e miratuar nga RQ). Numri i tyre marr pëlqim nga kryeredaktori. Me një ilustrim shoqërohet artikulli i vogël. Artikulli i mesëm dhe artikulli përmbledhës shoqërohen me deri tre ilustrime. Artikulli i gjatë mund të ilustrohet deri në katër figura. Të gjitha ilustrimet përmbajnë diciturë dhe burim (arkivin, autorin). Nëse ilustrimi citohet në tekst, krahas diciturës duhet të ketë dhe numërtim të brendshëm. Pavarësisht tipologjisë, në tekst ilustrimi citohet me shkurtesën *fig.* dhe numrin rendues (*fig. nr. 3*).

4. Madhësia e fotografive ilustruese për njësitë për personalitete përcaktohet nga RQ. Foto *faqe e plotë në botim* përdoret vetëm për artikujt monografikë. Nuk përdoren foto individuale për artikujt përmbledhës.

5. Ilustrime janë: fotot, harta, riprodhime të veprave të artit, skanime, vizatime, skica, figura gjeometrike, diagrama. QBEA negocion marrëveshje bashkëpunimi për garantimin e të drejtave të autorit me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave (*Fototeka e AQSH*) dhe arkiva të tjerë qendrorë; me ATSH e RTSH, me arkiva të tjerë.

6. Fotografitë mund të porositen nga autorët realizues të artikujve dhe të realizohet nga specialisti fotoreporter i punësuar në QBEA, ilustrimi mund të bëhet. Në këtë rast në vend të burimit në botim shenjohe *Copyright botuesi*, ndërsa në të dhënat në frontespis shenjohe emri i fotoreporterit të punësuar. Fotografitë nuk modifikohen, por detaje të rëndësishme mund të veçohen. Përmirësimet funksionale editoriale (dritë-hije, kontrast etj. parashikohen në procesin e fundmë shtypshkrues.

7. Ilustrimet me ngjyra propozohen nga autorët realizues dhe miratohen *me listë* nga RQ. Burimet ilustruese, të entit botuese dhe të tërthorta, janë të pakopjueshme, pa leje, përveç rasteve që shërbejnë për përrurimin e trashëgimisë kombëtare (për veshjet popullore shqiptare, veglat muzikore popullore, monumente të rëndësishme të natyrës dhe kulturës; imazhe të arkitekturës, banesave tradicionale, dorëshkrimeve të rralla; parqeve kombëtare, objekteve historike, rrallësive kombëtare).

VI. Referencat dhe bibliografia:

1. Në pajtim me kriteret themelore për hartimin e ESh, artikulli vlerësohet i realizuar dhe pranohet nga redaksia vetëm pasi të jetë shoqëruar me së paku dy referenca bibliografike ose dy-tre burime të plota e të sigurta. Referencat dhe burimet mbi kufirin kriterial janë të mirëpritura. Plotësimi i tyre nga autori është kusht kontraktues.

2. Sistemi referencial në tekstin e autorit bëhet si në një *njësi më vete*, sipas *Harvard System Referencies*, duke shenjuar në kllapa brenda në tekst vetëm mbiemrin e

autorit dhe vitin e botimit (**Malcolm: 1998**). Çdo citim i brendashkruar vlerësohet referencë apo burim si kusht ligjor dhe detyrimisht shenjohe në fund të artikullit me të njëjtin sistem, sipas këtij rendi njëses: mbiemri i autorit, emri me nistore, viti i botimit, vendi i botimit, enti botues dhe faqja (**Malcolm, N. 1998. *Kosovo: A Short History*. London, Macmillan, f. 89**). Kur citohet një revistë shkencore referimi i brendashkruar duhet të përmbajë mbiemrin e autorit e treguesin e faqes (**Podvorica: 45-47**), kurse në bibliografi shenjohe radhazi: autori (me mbiemër plus nistore të emrit), titulli i artikullit (me korsiv), periodiku ku është botuar, viti dhe faqjabrenda tekstit; **Podvorica, F. 2015. “Aspekte të historisë kulturore shqiptare në Kosovë”. *Gjurmime Albanologjike*, 45(1), Prishtinë pp. 65-84**. Nuk citohen në brendashkrim artikujt në të përditshme. Në rast të mungesës së citimeve në tekst përjashtimisht mund të pranohen burime nga shtypi popullarizues në bibliografi.

3. Nuk ka citime me fusnotë në artikullin enciklopedik.

4. Referencat e brendakryqëzuara (*crosreferencies*) mund të parashihi nga autorët, por si rekomandime që të shtohen në fazën e redaktimit përfundimtar të ESh.

5. Burimet arkivore nuk citohen të brendashkruara, por fraza e cituar përdalohet me korsiv dhe vlerësohet formalisht si njësi e cituar duke pasur të gjithë treguesit në bibliografi, si në përshkrimin nr. 15 të kreut II këtu.

6. RQ dhe gjithë editoria e ESh respektojnë në punën e tyre rregulloret për ngritjen dhe funksionimin e redaksive të periodikëve shkencorë dhe për veprimtaritë botuese të realizuesve të saj.

VII. Të tjera

1. Në rastet kur ky udhëzues nuk parashikon zgjidhjen e situatave a problematikave që mund të dalin gjatë hartimit, redaksitë e fushave mund të propozojnë plotësime.

2. Ky udhëzim u propozua nga drejtori i QBEA dhe u miratua në mbledhjen e RQ të datës __/__/2026. Udhëzimi vlerësohet si akt njëses për të gjitha marrëdhëniet e saj me editorinë dhe autorët.

KRYEREDAKTOR
Akad. Skënder GJINUSHI





**Akademia e Shkencave
dhe e Arteve të Kosovës**



**Akademia e Shkencave
e Shqipërisë**

**12 artikuj instruktivë përgatitur sipas *Udhëzuesit praktik dhe
Kritereve shkencore*
për hartimin e *Enciklopedisë shqiptare***

**Redaktuar e njësuar nga grupi i punës caktuar
në mbledhjen e *Redaksisë Qendrore* të datës 31 korrik 2023**

Miraturar në mbledhjen e *Redaksisë Qendrore* datë 7 nëntor 2023

Njësimet kryesore:

- 1. Hierarkia dhe madhësitë e artikujve**
- 2. Struktura**
- 3. Njësimi teknik**
- 4. Sistemi i referencave**
- 5. Sistemi i kryq-referencave (cross-references)**
- 6. Njësitë bibliografike**
- 7. Shkurtesat**

Tiranë, dhjetor 2023

Zorba, Zef (1920-1993). Poet, përkthyes, regjisor e libretist. Lindi në një familje shqiptare në Kotor të Malit të Zi. Shkollimin e nisi në Shkodër. Në vitin 1941 filloi studimet për shkencë politike në Padova, që i ndërpreu për shkak të luftës dhe u kthye në Shqipëri. Në vitet 1945-1946, i emëruar në shtëpinë e kulturës në Shkodër, vuri në skenë veprat *Juda Makabe* të Gjergj Fishtës dhe *Armiku i popullit* të Henrik Ibsen-it, të cilat nuk u mirëpritën zyrtarisht. Në vitin 1946 u akuzua si kundërshtar i regjimit e u dënua me burg e kampe pune deri më 1951. Pas lirimit u kthye në Shkodër, ku punoi si llogaritar, deri në vitin 1980, kur doli në pension.

Krijimtaria letrare e Z. Z. u bë e njohur vetëm pas vdekjes, kur doli libri me poezi *Buzë të ngrira në gaz*, shkruar si *letërsi sirtari*. Shkroi librete për opera, me subjekte nga mitologjia dhe lashtësia (*Teuta, Rozafa*), tekste këngësh dhe poezi. Poezia e tij lirike ndërthur në forma elitare fjalën dhe muzikën, larg poetikës vendëse, të traditës e bashkëkohësës, që ishte futur në rrjedhat e realizmit socialist. Poezia e tij ndenji më pranë referencave kulturore sesa atyre historike-sociale.

Z. Z. njihet dhe si përkthyes e shqipëruës i autorëve të tillë si B. Croce, B. Show, E. Montale, G. Ungaretti, S. Quasimodo, O. Wilde, T. S. Eliot, L. Pirandello, R. Frost etj. Përveç librave *Buzë të ngrira në gaz* (1994; 2016); *Perfectum trinum* (2019, përkthime / grup autorësh); *Poezia* (2021), ky autor ka lënë krijimtari edhe në publicistikë e studime. Ndërroi jetë më 1993 dhe prehet në Shkodër.

I pajisur me kulturë të gjerë letrare e filozofike dhe njohës i thelluar i gjuhëve të huaja, Z.Z. përfaqëson shkrimtarin virtuoz dhe erudit, që zgjodhi heshtjen e vetminë në vend të kompromisit dhe kundërvënien estetike ndaj modelit ideologjik. Duke mbetur një nga rastet e spikatura të ndikimit së letërsisë moderne perëndimore, ai vlerësohet si autor kyç që vazhdoi fillet e modernitetit të viteve 1930, i prirur drejt kodit estetik të hermetizmit, urë lidhëse mes dy periudhave letrare. **A.L.**

Bibliografi:

Elsie, Robert: *Albanian literature, albanian authors - Zef Zorba*, faqe digjitale e autorit.

Lanksch, Hans-Joachim: *Zef Zorba: një hermetist shqiptar*, Phoenix, nr. 1, Tiranë 1997.

Braholli, Riza: *Poetika e refuzimit estetik në poezinë tonë: Zef Zorba dhe Frederik Rreshpja*, tezë doktorate, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë i UT, Tiranë, 2017.

HATIBI, Ervin (1974-). Poet dhe eseist. Mësoi frëngjisht në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja *Asim Vokshi*. U diplomua për gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës; u specializua më tej në Jordani për gjuhë dhe qytetërim arab. Përmbledhjen e tij të parë me poezi, *Përditë shoh qiellin* (*Naim Frashëri*, Tiranë 1989), e botoi në moshën 15-vjeçare, shoqëruar me një parathënie prej I. Kadaresë, i cili e quajti atë *vazhdimësia dhe e ardhmja e letërsisë shqipe*. Libri i dytë me poezi i E. H. titullohet *6 Maç* (*Marin Barleti*, Tiranë 1995), vijuar nga *Pasqyra e Lëndës* (*Ora*, Tiranë 2004); *Republic of Albania* (përmbledhje me ese, *Ora*, Tiranë 2005), *Një gjarpër i viteve gjashtëdhjetë dhe të tjera tregime zoologjike* (*Vizioni M*, Tiranë 2018) dhe *Transkript nga krevati tjetër* (*Onufri*, Tiranë: 2020). Disa lirika të tij u bënë tekste këngësh dhe faqe letrare për pjesë për bariton dhe piano (*Sarajevaljum* 1996). Poezitë e tij janë përkthyer italisht, maqedonisht, anglisht dhe spanjisht dhe janë përfshirë në disa antologji të letërsisë europiane.

Në vitin 1992 E. H. bashkëthemeloi revistën letrare avangardë *E për-7-shme*, zëdhënëse e një grupimi të rinjsh që vendosën të ndiqnin rrugën e tyre kontestuese, shprehur përmes poezive, eseve dhe artikujve mbi çështje kulturore e sociale, të cilat më pas përfshinë edhe çështje të artit dhe besimit.

Krijimtaria e E. H. është përkthyer e botuar në antologji të ndryshme të poezisë shqipe në gjuhën italiane, spanjolle, maqedonase, angleze etj.

Përveç poezisë, ku ai ka gjurmën e vet ndikuese në peizazhin poetik shqiptar pas viteve 1990, E. H. krijoi edhe në artet grafike, duke kultivuar pasionin për pikturën dhe kolazhin. Ekspozita e tij të parë u çel në pranverën e vitit 1991 (GKA), për t'u ndjekur me pjesëmarrjen në *Printemps-Eternité 2003* (Paris), *Pop-Ferman* (Ferrara 2004), në Stamboll (2008), në Pragë (2009) etj. Lektor në Universitetin e Stambollit. **A.L.**

Bibliografi:

Perdazzi, Nicola: *Tirana: a casa di Ervin Hatibi*, në *Osservatorio Balcani e Caucaso Transeuropa*, 19 shkurt 2015.

Bremer, Alida: *Autorinnen und Autoren aus Südosteuropa*, Leipzig 2011.

Kongresi Kombëtar i Elbasanit (2-8 shtator 1909)

Artikulli i vogël, 2876 shenja, përgatiti Marenglen Kasmir

Kongresi me karakter mbarëshqiptar, që mori vendime të rëndësishme për përhapjen e shkollave shqipe dhe për probleme të tjera të lëvizjes kombëtare. U thirr me nismën e *klubit shqiptar të Selanikut*. Morën pjesë 35 delegatë, përfaqësues të klubeve dhe shoqërive shqiptare, midis të cilëve Orhan Pojani, Grigor Cilka, Gjergj e Sevasti Qirjazi, Mithat Frashëri, Dervish bej Biçaku, Refik Toptani, Ahmet Dakli, Hamdi Ohri, Abdullah Koprëncka, Thoma Papapano, Nikollë Kaçorri, Simon Shuteriqi, Dhimitër (Taq) Buda, Selman Blloshmi etj. U drejtua nga një kryesi e përbërë nga katër veta, me kryetar Dervish bej Biçakun, nënkryetar Mithat Frashërin dhe sekretarë Simon Shuteriqin e Josif Haxhimimën.

Në Kongres u shqyrtuan tri çështje themelore: çelja e një shkolle normale; krijimi i një qendre të vetme për drejtimin, për organizimin dhe për financimin e shkollave shqipe dhe marrja e masave për bashkërendimin e veprimtarisë së klubeve shqiptare. Akti themelor i Kongresit ishin *vendimet*, që njihen si *Rezoluta prej 15 nenesh*, e cila u miratua dhe u nënshkrua nga gjithë delegatët. Vendimet e Kongresit të Elbasanit i dhanë një hov të mëtejshëm lëvizjes kombëtare e në mënyrë të veçantë luftës për përhapjen e shkollave dhe të shkrimit shqip.

Me çeljen në Elbasan në vjeshtë të atij viti të shkollës *Normale*, një shkollë e mesme pedagogjike me gjashtë klasa, që do të përgatiste mësues për shkollat fillore shqipe, u realizua vendimi themelor i Kongresit. *Normalja* do të mbahej me kontributin e të gjitha klubeve dhe shoqërive shqiptare. U vendos gjithashtu të ngrihej në Korçë shoqëria qendrore shkollore *Përparimi*, e cila do të kujdesej për mbajtjen dhe administrimin e shkollës normale, do të punonte për hapjen e shkollave të tjera shqipe, si dhe për botimin e librave dhe teksteve shqipe. Do të kërkohej që shoqëria *Përparimi* të njihej zyrtarisht si *person juridik* prej qeverisë osmane. U ngarkuan të gjitha klubet e shoqëritë, sidomos klubi *Bashkimi* i Manastirit, që të punonin për futjen e gjuhës shqipe kudo në shkollat e vendit dhe për të siguruar për këtë lejen zyrtare të qeverisë. Në mbledhjet e mbyllura delegatët shprehën mosbesimin dhe kundërshtimin ndaj regjimit xhonturk, vendosmërinë për të siguruar autonominë e Shqipërisë dhe nevojën e organizimit më të mirë të komiteteve të fshehta që vepronin pranë klubeve. **M.K.**

Bibliografi:

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëll. II, bot. ASHSH, Tiranë 2008.

Historia e popullit shqiptar, bot. ASHSH, vëll. III, Tiranë 2002.

Lloshi, Xhevat: *Rreth alfabetit të shqipes: me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit*, bot. Logos-A, Shkup 2008.

Hatellari, Manjola: *Kongresi i Elbasanit dhe shkolla Normale në historinë e arsimit dhe kulturës shqiptare (bibliografi shqipe e anotuar: 1909-2009)*, bot. Flesh, Tiranë 2012.

Bageri, Josif (1868-1915). Poet, publicist, veprimtar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Lindi më 1868 në fshatin Nistrovë të Rekës së Epërme, zonë e Malësisë së Dibrës, sot në Maqedoninë e Veriut. Fëmijërinë dhe një pjesë të rinisë i kaloi në vendlindje. Për shkak të rrethanave shoqërore dhe ekonomike nuk pati mundësi të arsimohet. Kushtet e vështira të jetës e detyruan që në 1887 të mërgojë në Sofje, ku punoi në një këpucari. Si njeri i vetëformuar J. B. u angazhua në kuadër të organizimit politik dhe kulturor të kolonisë shqiptare të Sofjes. Që ndër ideatorët e krijimit të shoqërive shqiptare *Dëshira* dhe *Afron dita* dhe një ndër veprimtarët kryesorë të tyre. Në periudhën 1909-1911 J. B. drejtoi gazetën *Shqypeja e Shqipënis*, organ përparimtar e demokratik në prag të pavarësisë së Shqipërisë. Më 1914 J. B. la Sofjen dhe shkoi në Durrës, ku për një kohë të shkurtër drejtoi gazetën *Ushtimi i Krujës*, e afërt me qeverinë e Princ Vidit. Vdiq në Prishtinë në vitin 1915.



Krijimtaria e J. B. i shërbeu formimit të ndërgjegjes kombëtare të bashkatdhetarëve dhe ndikoi në vetëdijësimin e bashkësisë shqiptaro-ortodokse të krahinës së tij lidhur me raportet e përbërësve të identitetit kombëtar (gjuhë, etni, besim). Me aspiratat kombëtare për pavarësi, qëndrimet rreth kombit, gjuhës, arsimit e kulturës shqiptare, lidhjet e drejtpërdrejta e produktive me veprimtarët e shquar të kohës dhe me veprimtarinë e tij, J. B. përfaqëson shkallën e vetëdijes shqiptare në Rekë.

Gjatë dhjetëvjeçarit të parë të shekullit XX, J. B. shkroi mjaft artikuj: letra, thirrje, fejtone, pamflete, reportazhe, përshtypje udhëtimi, vëzhgime (Mata, 2019:119), ku paraqiti profilin publicistik dhe qëndrimet e tij politike. Në vitin 1910 në Sofje J. B. botoi vëllimin *Kopësht malsori - Msime të shqyptarueta dhe vjersha*, që përmban tekste të shkurtra leximi (*Atënia ky emën i bukur, Ujë, Zarmi dhe Nderi, Malli i amës, Përtesa e varfunia, I mbetuni pa mësim* etj.) dhe poezi atdhetare e didaktike-edukative të shkruara me frymën popullore (*Fjal të vërteta, Shtëpia ime, Sende të vërteta, Para fytyrës Naim Frashërit, Eni të gjith në mësimtore, Vajtim e mallkim* etj.).

J. B. konsiderohet si themelues i letërsisë etnografike të Dibrës me rrethinë. Gazeta që ai botoi është e para dhe e fundmja që u shkrua në këtë nëndialekt mjaft konservativ (Sinani, 2019:9). **V.T.**

Bibliografi:

- Bageri, Josif: *Kopësht Malsori - Msime të shqyptarueta dhe vjersha* (përgatitur nga Ruzhdi Mata), Tiranë 2019.
- Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëll. I, ASHSH, Tiranë 2008.
- Mata, Ruzhdi, *Josif Bageri: jeta dhe veprat*, Tiranë 2018.
- Janura, Petro: *Josif Bageri poet i mislitel od gorna Reka*, bot. Naucen Sobir, Shkup 1978.
- Pepo, Petraq, *Katër letra të shkrimtarit demokrat Josif Bageri*, në *Arsimi popullor*, Tiranë 1962.
- Sinani, Shaban, *Josif Bageri i Rekës së Dibrës*, në *Pyetje të tjera në albanologji: autorë dhe teza*, bot. Naimi, Tiranë 2017.

Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918)

Artikull i mesëm, 5609 shenja, përgatiti Aljula Jubani

Komisia Letrare Shqipe (KLSH) u mbledh në vitin 1916 në Shkodër, me nismën e elitës intelektuale të kohës dhe me mbështetjen e konsullit të përgjithshëm të Austro-Hungarisë e të komandës ushtarake në Shkodër. KLSH u ngrit si një *zyrë më vete*, por, me ndryshimet statutore më 1917, e vijoi punën e saj pranë drejtorisë së përgjithshme të arsimit. KLSH, me statutin e vet dhe me njohjen nga komanda ushtarake austro-hungareze, mori përsipër të gjente zgjidhje të disa problemeve madhore për çdo shtet: për *gjuhën zyrtare dhe zhvillimin e botimeve e të shkollës shqipe*, duke u bërë shprehëse e vullnetit mbarëkombëtar dhe i autoritetit intelektual.

Austro-Hungaria edhe më parë kishte treguar vëmendje ndaj Shqipërisë, përfshirë Shkodrën, me nisma të rëndësishme institucionale. Komanda e lartë ushtarake e saj lejoi *përdorimin e simboleve kombëtare*, njohu *gjuhën shqipe si gjuhë mësimi*, nxiti *përpunimin e terminologjisë shqipe* të administratës dhe të asaj arsimore. Deri në vitin 1918 jo vetëm në Shqipëri, por dhe në territoret e Kosovës që kontrolloheshin nga Austro-Hungaria, mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.

KLSH nxiti angazhimin e mendjeve më në zë të shqiptarizms: intelektualë e patriotë, një pjesë e të cilëve qenë pjesëmarrës edhe në Kongresin e Manastirit: Gjergj Pekmezi, Luigj Gurakuqi, At Gjergj Fishta, Dom Ndre Mjeda, Mati Logoreci, Sotir Peci, Hilë Mosi, Aleksandër Xhuvani, Imzot Vinçenc Prennushi, Luigj Naraçi, Ndue Paluca, At Ambros Marlaskaj, Hafiz Ali Korça, Josif Haxhimima, Sali Nivica. Kontribues të rëndësishëm ishin Rajko Nahtigal e Maximilian Lambertz. Kryetar i saj u zgjodh Gjergj Pekmezi e më pas Luigj Gurakuqi.

KLSH u mbledh në vijim të Kongresit të Manastirit (1908) e Kongresit të Elbasanit (1909) dhe në përmbushje të kërkesave të shumta për gjetjen e zgjidhjes në lidhje me *variantin e përbashkët të shqipes zyrtare, kodifikimit të rregullave të drejtshkrimit*, si edhe të një sërë çështjesh të tjera në lidhje me administratën dhe shkollën shqipe. KLSH, në *historin e zhvillimit t'onë gjuhësuer, xen një vend të përmendun ... ende sot administrata shqiptare do t'i përnderet shumë* (F. Fishta, 1944:62).

Veprimtaria e KLSH ndërmori e u dha udhë një sërë problematikash të gjuhës e të arsimit shqip. Në vitin 1917 KLSH miratoi kodin e parë për drejtshkrimin e shqipes *Rregullat mbi ortografinë e gjuhës shqipe të shkrueme dhe, menjëherë pas tij, manualin Parime e rregulla mbi ortografinë e gjuhës së shkrueme*, shoqëruar me një fjalës (*Radhue fjalësh*), ku përfshiheshin edhe terma për *gjyqje e administrata*. Këto parime, të miratuara më pas dhe nga Kongresi arsimor i Lushnjës (1920), hynë në fuqi me vullnet të qeverisë në vitin 1923. Kjo punë shërbeu edhe në kodifikimin e shqipes standarde disa dhjetëvjeçarë më pas.

KLSH, duke zgjedhur si bazë elbasanishten, shfaqti hapur vullnetin e përbashkët për të tejkaluar parapëlqimet. *Parimi drejtues për të gjetur si bazë të gjuhës letrare një variant dialektor që do të ishte më i afërt për të gjithë nuk mund të mos pëlqehet* (Ismajli, 2021: 28). Veç dhënies së zgjidhjes për variantin gjuhësor të zyrtarizuar, mbi bazën e të cilit do të ngrihej drejtshkrimi, KLSH ndërmori edhe nisma të tjera në lidhje me toponomastikën dhe antroponiminë, terminologjinë e administratës etj. Në vitin 2018 u botuan në dy numra *Laimet e Komisis Letrare Shqipe në Shkodër*. Ndër to, me rëndësi të veçantë është themelimi i *bibliotekës së Komisisë* drejtuar nga Hilë Mosi. Themelimi i saj u shoqërua edhe me përgatitjen e një rregulloreje funksionimi, shoqëruar me udhëzime për mënyrën e pasurimit. Në këtë tribunë shkruhet: *Tue marrë para sysh se gjuha shqype mjerisht deri tashti nuk*

ka qenë e livrueme edhe e punueme nepër shkolla e administratë si gjuhë e përgjithshme edhe e përbashkme edhe tue qenë se visari i gjuhës nuk është i përmbledhun ene, për ket shkak komisis i bije për barrë hartimi i një shumicës së madhe të termave teknike. Duhet pra të ruhet fort si nga neologizmat, si nga barbarizmat e teperme; mbassi nga neologizmat kuptimi i gjuhës do të bëhet shumë i vështirë; në vend që nga barbarizmat gjuha do të bjerri ngjyrën kombtare (Osmani, 2016:221).

Biblioteka e KLSH do të përbënte fillesën e Bibliotekës Kombëtare, të themeluar në vitin 1920, e cila trashëgoi edhe vëllimet e saj. *Tue qenë se mbas urdhnit të Kryekomandës nr. 1106 u mblodh një pjesë e librave të bibliotekës edhe tue qenë se mbas këtij urdhëni, për me mbajt në rregullim bibliotekën duhet të mbahet regjistër, inventar etj., po zgjidhet si bibliotekar i bibliotekës së komisis z. Hilë Mosi. U vendue edhe me i u lutun Kryekomandës të çpalli një urdhën, që secili auktor e editor të jetë i detyruem t'i japë bibliotekës nga dy eksemplare gratis të çfarëdo botimit (Osmani, 2016:229). Në Laimet e Komisis thuhet gjithashtu se ajo do të flasë edhe mbi thema të nxjerruna prej lëndës së ditunis së gjuhës shqipe, prej historis së re e të vjetër të Shqipnis, prej prehistoris së komit shqiptar e prej archeologjis e dheshkrones shqipe (Osmani, 2016:203). KLSH, nisur nga përmasat e vendimeve të marra, ishte jo vetëm pararendëse, por edhe i shërbeu krijimit të institucioneve të mëpasme shkencore shqiptare për gjuhën, letërsinë e më gjerë. A.J.*

Bibliografi:

Fishta, Filip: *Luigj Gurakuqi- njeriu shtetit e shkrimtari*, Hylli i Dritës, nr. 3, 1944.

Fjalor Enciklopedik Shqiptar, vëllimi II, ASHSH, Tiranë 2008.

Ismajli, Rexhep: *Drejtshkrimet e shqipe*, ASHSH, Tiranë 2021.

Osmani, Tomor: *Shekulli i Komisisë Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918)*, Edlora, 2016.

GALICA, Azem Bejtë, luftëtar i më i shquar popullor për çlirim e të drejta kombëtare në vitet 1918-1924 dhe organizator e drejtues i rezistencës së armatosur në Kosovë, Galicë e Drenicë në Kosovë XII.1889-Perçevë/Gllarevë e Prekorupes, 24.VII.1924.

Lindi në Galicë të Drenicës në një familje atdhetare. I ati, Bejtë Galica, ishte luftëtar i njohur i kryengritjeve antiosmane dhe i qëndresës kundër ekspansionit serb qysh në vitet 70-të të shek.XIX. U vra më 1906 nga forcat ushtarake osmane gjatë shtypjes së një revolte popullore në Drenicë (Haxhiu, 1976:6).

Fillimet e veprimtarisë atdhetare të A.G. lidhen me *kryengritjen antiosmane* që shpërtheu në Kosovë në pranverë 1910. Bashkë me dy vëllezër mori pjesë në *kryengritjen e përgjithshme antiosmane* (1912). Gjatë *luftës ballkanike* u inkadrua në qëndresën kundër forcave pushtuese serbe (FESH, 2018:750). Luftoi në frontin e Podujevës kundër reparteve të armatës së tretë serbe dhe më pas në Drenicë, derisa u zu në rrethim prej tyre dhe u mbyll në kampin e shfarosjes në Rudnik. Në të dalë të dimrit mundi të arratisë, por përsëri u zu dhe u internua në brendësi të Serbisë, në kampin e Pozharevacit. Në pranverë 1915 arriti të arratisë e u kthye në Drenicë. Qysh nga kjo kohë A. G. u bë pjesëtar i *lëvizjes kaçake*. Në vjeshtë, dy javë pas martesës, iu bashkua edhe e shoqja, *Qerimja* 19-vjeçare, e njohur me emrin *Shotë*. Në luftime kundër xhandarmërisë serbe gjatë vitit 1915 humbi vëllezërit dhe iu dogj përsëri shtëpia e rrënuar së pari më 1906 nga forcat osmane (Haxhiu, 1976: 30). Pas largimit të forcave serbe në fund të vitit 1915 mori pjesë në luftime kundër forcave austro-hungareze e bullgare, që kishin krijuar zonat e tyre të pushtimit. Luftimet në Lushtë, Galicë, Kozhicë, Dubovcë, Terdefc e veçanërisht në Obrijë gjatë periudhës shkurt 1916 - mars 1917 e bënë të njohur në të gjithë Kosovën. Në korrik 1917, pas vrasjes së *Shaqir Smakës*, A. G. u bë drejtuesi kryesor i kryengritësve në Drenicë dhe drejtuesi i luftimeve që pasuan gjatë gjysmës së dytë të atij viti në Kollëdrenicë, Bajë, buzë lumit të Sitnicës etj. (Çitaku, 1996:17-22). Në vjeshtën e vitit 1918 sipas orientimeve të Komitetit "*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*", u mor vesh me drejtuesit e forcave çetnike serbe për aksione kundër trupave ushtarake austro-bullgare të dislokuara në Kosovë (Historia, 2017, vëll.I: 506-507). Ndërmori aksione sulmuese kundër postkomandave austriake në katundet Vojnik, Kopiliq, Mikushnicë, Radishevë, Rudnik, Rakosh dhe në krye të 350-400 luftëtarëve arriti të çlirojë Drenicën, Podgorin dhe qytetin e Pejës. Forcat franko-serbe të frontit të Selanikut, që depërtuan nga fundi i tetorit në Kosovë, e gjetën krahinën përgjithësisht të çliuar. Komandanti i tyre francez *Bashle* vlerësoi rolin e A. G. për largimin e forcave austro-hungareze nga Kosova (Historia, 2017, vëll.I: 509).

Rivendosja e pushtetit ushtarak policor në Kosovë nga Serbia e më pas Mbretëria Serbo-Kroate-Sllovene në kundërshtim me aspiratat e popullsisë shqiptare, shoqëruar me politikën shkombëtarizuese, e rigjallëruan lëvizjen e rezistencës dhe për çlirim e bashkim kombëtar. A. G. ishte ndër prijësit e kryengritësve, të cilët, nën drejtimin e komitetit *Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*, në pranverën e vitit 1919 shkallëzuan luftën me çeta. Bashkë me *Sadik Ramën*, *Ramadan Shabanin* dhe *Zef Gjiodën*, u vu në krye të afro 10 mijë luftëtarëve, që, me programin dhe kërkesat e qarta kombëtare të hartuara nga KMK, gjatë periudhës prill-maj, morën pjesë në *kryengritjen e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Drenicës* (Çitaku, 1996:173). Pas shtypjes së kësaj kryengritjeje A. G. ishte përsëri në krye të çetave të Kosovës. Masakrimi i gjithë të afërmëve dhe djegia për herë të tretë e shtëpisë (korrik 1920) e bënë edhe më aktiv. Në drejtimin e tij, sipas vendimeve të kuvendeve të organizuara nga pjesëtarët e çetave nga vise të ndryshme të Kosovës, u forcua kundërshtimi i dhunës dhe i terrorit të regjimit jugosllav,

u asgjësuan bashkëpunëtorë të tij më të rrezikshëm, u intensifikua propaganda kundër politikës së shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi (Rushiti, Lëvizja:131).

Gjatë viteve 1920-1924 A. G. përballoi luftime të shumta dhe diti ta mbante gjallë lëvizjen e armatosur në Kosovë. U angazhua edhe në përpjekjet e opozitës në Shqipëri për të marrë pushtetin me dhunë. Nga nëntori i vitit 1921 deri në shkurt të vitit 1923 ishte ndër mbrojtësit kryesorë të "zonës neutrale" të Junikut, bazës së kryengritësve të Kosovës e të malësisë së trevave verilindore. Në periudhën korrik 1923 - korrik 1924 mbrojti një zonë të lirë në zemër të Drenicës, të quajtur në mënyrë simbolike *Arbania e vogël* (Historia, 2019, vëll.II: 625, 627, 629).

I lidhur ngushtë me figura të shquara të elitës opozitare politike shqiptare të kohës, me *Hasan Prishtinën*, *Bajram Currin*, *Kadri Prishtinën*, në vitet 1922-1924 A. G. përkrahu kryengritjen e malësorëve të prefekturës së Kosovës (Krumë) kundër qeverisë së Tiranës; ndërsa në maj 1924 dërgoi luftëtarë për t'iu bashkuar forcave të armatosura të Bajram Currit që mësynë Tiranën. Për veprimtarinë e tij kryengritëse A. G. u dënua dy herë me vdekje, nga autoritetet e Beogradit (1920) dhe ato të Tiranës (1923) (Historia, 2019, vëll.II: 631).

Në verën e vitit 1924, ndërkohë që në Jugosllavi e Greqi përgatitej ndërhyrja për përmbysjen e qeverisë së Fan Nolit, autoritetet e Beogradit vendosën likuidimin e A. G., hap që llogaritej të sillte shuarjen e lëvizjes kryengritëse në Kosovë. Në luftimet e përgjakshme të zhvilluara më 14 korrik A. G. u plagos rëndë. Vdiq më 24 korrik; çetat kryengritëse i vazhduan aksionet edhe 4 vjet. Bashkëluftëtarët e varrosën trupin e A. G. në fshehtësi në shpellën *Çuku që kërcet*, midis Përçevës dhe Gllarevës (Prekorupë). Në vitin 1971, me përpjekjet vullnetare të disa intelektualëve, eshtrat u nxorën nga thellësia vertikale e shpellës prej 82 metrash dhe u vendosën në memorialin e ngritur në fshatin e tij të lindjes. Më 25 korrik të vitit 1990 në Galicë u bë një tubim i madh popullor, me pjesëmarrjen e rreth 20 mijë vetëve në kujtim të prijësit kryengritës.

Në vlerësim të veprimtarisë atdhetare, me dekretin nr. 435, datë 26.1.1993 të Presidenit, A. G. është dekoruar me *Urdhrin e Lirisë të Klasit I. M.V.*

Bibliografi:

Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, vëll.I, II, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë, 2017/2019.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar (FESH), vëll.I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008.

Haxhiu, Ajet: *Shota dhe Azem Galica*, bot. shtëpia botuese 8 Nëntori, Tiranë 1976.

Rushiti, Liman: *Lëvizja kaçake në Kosovë (1918-1928)*, bot. Instituti i Historisë i Kosovës, Prishtinë 1981.

Çitaku, Ibrahim, *Azem Galica dhe veprimtaria luftëtare e çetave kaçake të Drenicës*, Prishtinë, 1996.

Konferenca e Bujanit (1943-1944) është konferenca themeluese e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit.

Vendimi për këtë u mor nga Komiteti Krahinor i Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovë dhe Metohi (Dukagjin) në *këshillimin e Sharrit* (4-6 nëntor 1943), me pjesëmarrjen e disa anëtarëve të shtabit kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për Kosovë e Metohi (UNÇKM) dhe të përfaqësuesve të Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste Jugosllave - PKJ (FEK, 2018: 836).

Konferenca u mbajt në fshatin *Bujan* të Malësisë së Gjakovës, në shtëpinë (kullën) e Sali Manit, më 31 dhjetor 1943 deri në 2 janar 1944. Aty vepronin batalionet partizane antifashiste *Bajram Curri*, *Rinia*, *Perlat Rexhepi* dhe gjendeshin të strehuar shtabi kryesor i UNÇ dhe Komiteti Krahinor i PKJ për Kosovën. Nga 61 delegatët e ftuar, në KB morën pjesë 49. Ali Shukriu dhe Milan Zeçari u trajtuan si pjesëmarrës të konferencës, pasi kishin njoftuar me shkrim që më parë për pamundësinë e pjesëmarrjes për shkak të situatës dhe se do të pajtoheshin me të gjitha vendimet e saj. Sipas përkatësisë kombëtare, prej 51 delegatëve 43 ishin shqiptarë, 4 serbë, 3 malazezë dhe 1 mysliman. Nuk morën pjesë 12 delegatë, për arsye të kushteve të vështira të krijuara nga rrethanat e luftës (Nasi, 1994: 81).

Nga pikëpamja e përfaqësimit politik e social KB ishte *me bazë të gjerë përfaqësimi*. Shumica e pjesëmarrësve ishin komunistë, por kishte dhe nacionalistë, atdhetarë demokratë, përfaqësues të njëjësive të armatosura, të rinisë e të gruas antifashiste dhe të këshillave nacionalçlirimtare. Morën pjesë delegatë edhe nga treva e Plavës dhe Gucisë, që u trajtua si pjesë e pandarë e Kosovës; si dhe disa delegatë nga Malësia e Gjakovës, administrativisht territor Shqipërisë, që vepronin në formacionet partizane të Kosovës (FESH, 2008: 1243).

Përgatitjet për KB i bëri Komiteti Krahinor i PK Jugosllave për Kosovën, që drejtohej nga *Pavle Jovičević*. Në KB u thirr e mori pjesë dhe një përfaqësues i misionit britanik pranë shtabit kryesor (major Brailly). KB zgjati tri ditë. Punimet e saj u hapën nga *Xhevdet Doda*, delegat i brigadës kosovare-maqedonase. Përveç kryesisë së punës prej 7 anëtarësh dhe 2 mbajtësve të procesverbaleve, u zgjodh edhe këshilli verifikues prej 3 anëtarësh. Konferencën e përshëndetën *Fadil Hoxha*, komandant i shtabit kryesor të UNÇ dhe reparteve partizane për Kosovën, i cili foli për sukseset e luftës nacionalçlirimtare në Kosovë; *Pavle Jovičević*, sekretar i KK të PKJ, i cili foli për rolin udhëheqës të PKJ-së në Luftën NÇI; *Xhafer Vokshi*, përfaqësues i Komitetit Krahinor të Rinisë Komuniste, i cili trajtoi rolin e rinisë në LNÇI; *Sabrie Vokshi*, përfaqësuese e Frontit Antifashist të Grave të Kosovës, e cila foli për rolin e grave; *Mehmet Bajraktari*, delegat i Kraniqes, që revokoi traditën patriotike dhe luftarake të trevës; si edhe *Xhevdet Doda* (Historia, 2021: 516).

Më 1 janar 1944 filloi seanca e rregullt e Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar (KKN). Në të u mbajtën dy referate: i pari nga *Mehmet Hoxha*, që analizonte situatën politike në vend, rajon dhe botë; i dyti nga *Xhavit Nimani*, që trajtoi detyrat dhe rolin e KKN. Pas përfundimit të diskutimeve, komisioni i ngarkuar për hartimin e dokumenteve të konferencës, i përbërë nga *Zekeria Rexha*, *Hajdar Dushi*, *Mehmet Hoxha*, *Pavle Jovičević*, *Xheladin Hana*, *Fadil Hoxha*, *Xhavit Nimani* e *Mita Milković*, paraqiti për miratim Rezolutën e Konferencës, si dhe *Thirrjen drejtuar popujve të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit*. Rezoluta shpallte qëllimin e KB për forcimin e vëllazërimit të popujve dhe për bashkimin e të gjithë patriotëve të ndershëm, pa dallim feje, kombësie e tendence politike, në luftën e armatosur kundër pushtuesit fashist dhe

bashkëpunëtorëve të tij. Rezoluta njohu faktin se Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit ishin territore të banuara me shumicë shqiptare. Edhe pse pati mospajtime, veçanërisht midis P. Jovičević-it e H. Dushit, në Rezolutë u deklarua aspirata e shqiptarëve të Kosovës për bashkimin me Shqipërinë përmes luftës së vendosur kundër pushtuesit dhe se pas luftës do të zbatohet parimi universal që u njeh popujve të drejtën të vetëvendosin deri në shkëputje: *Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është krahinë e banueme me shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot, dëshiron me u bashkue me Shqipërinë*. Rezoluta rekomandonte se rruga që duhej ndjekur për të realizuar aspiratat kombëtare të popullit të Kosovës ishte angazhimi në luftën e përbashkët me popujt e tjerë kundër pushtimit nazist. *Përmes kësaj lufte, të gjithë popujt, pra, edhe populli shqiptar, do të kenë mundësi me vetvendosë mbi fatin e tyre, me të drejtën e vetvendosjes deri në shkëputje*. Garantë të kësaj vlerësoheshin: UNÇ e Jugosllavisë dhe UNÇ e Shqipërisë, aleatët e mëdhenj (Bashkimi Sovjetik, Anglia e Amerika) dhe dokumentet themelore të antifashizmit (Karta e Atlantikut, vendimet e Konferencës së Moskës e të asaj të Teheranit). Vendimet e KB ishin në përputhje me deklaratën për të drejtën e vetëvendosjes të vetë udhëheqësve të PKJ FEK, 2018: 837).

Pas miratimit të *Rezolutës* dhe të *Thirrjes* KB u dha fund punimeve dhe u shndërrua në Këshill Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, organit më të lartë të pushtetit në Kosovë. Nga radhët e tij u zgjodh Kryesia e KKKN prej 9 anëtarësh me këtë përbërje: M. Hoxha (kryetar), P. Jovičević (nënkryetar), Rifat Berisha (nënkryetar) dhe Xh. Doda, F. Hoxha, H. Dushi, Z. Rexha, M. Zeçari e A. Shukriu (anëtarë) (FEK, 2018: 837).

Punimet e KB dhe vendimet e saj patën jehonë në Kosovë. Popullsia shqiptare e Kosovës dhe organizmat e Luftës NÇI i miratuan dhe i pritën me gëzim e shpresë vendimet e saj, që u përshëndetën edhe nga Lëvizja NÇI e Shqipërisë, ndërsa udhëheqja jugosllave i kundërshtoi ato. Më 28 mars 1944, një letër e Komitetit Qendror të PK Jugosllave, e nënshkruar nga Milovan Gjilasi, sulmoi në mënyrë të veçantë vendimet e KB për realizimin e *së drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje* të shqiptarëve të Kosovës pas fitores mbi fashizmin. Mosnjohja nga PK Jugosllave e attributeve të pushtetit politik të KKN të Kosovës rriti pezmatimin dhe mosbesimin e shqiptarëve për politikën e PK Jugosllave ndaj tyre. M.V.

Bibliografi:

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëll. II, bot. ASHSH, Tiranë 2008.

Fjalori Enciklopedik i Kosovës, vëll. I, bot. ASHAK, Prishtinë 2018.

Historia e popullit shqiptar, vëll. IV, bot. Toena, Tiranë 2009.

Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, vëll. IV, bot. ASA, Tiranë, 2021.

Konferenca e Bujanit (akte të konferencës), Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë 1999.

Konferenca e Bujanit (akte të konferencës), bot. ASHSH, Tiranë 1999.

Nasi, Lefter: *Ripushtimi i Kosovës (shtator 1943-korrik 1944)*, bot. ASHSH, Tiranë 1994.

Shatri, Muhamet: *Kosova në Luftën e Dytë Botërore (1941-1945)*, bot. Toena, Tiranë 1997.

Bitumi natyror (ose sera a zifti) është një lëndë organike në trajtë lëngu me veshtulli jashtëzakonisht të lartë, ose masë e ngurtë me ngjyrë të errët-të zezë, e djegshme. Në lashtësi, një lëndë si katran që nxirrej në miniera quhej *asfaltos* (nga greq. e vjetër), ndërsa fjala *bitum*, *bitumen*, ka prejardhje latine, terma që shpesh përdoren si sinonime, por në praktikën e ndërtimit *asfalt* quhet një përzierje e bitumit me çakëll të imët a rërë që përdoret për shtrimin e rrugëve. Nga pikëpamja kimike bitumi përbëhet kryesisht nga hidrokarbure policiklike aromatike dhe përmban: karbon (C = 80-85%), hidrogjen (H = 9-10%), squfur (S = 4-6%), si dhe azot (N = 0,5-1%) e oksigjen (O = 0,5-1%) dhe shkrin në 90-120°C.

Miniera e Selenicës është miniera e vetme për nxjerrjen e bitumit natyror jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Evropë. Bitumi i saj i njohur dhe i shfrytëzuar që në lashtësi vazhdon të nxirret edhe sot; është bitum i cilësisë së lartë (që përmban deri në 86% bitum natyror të pastër) (Guxho 2008:1724). Në literaturën e specializuar emërtohet edhe si *albanit* (Diamanti e Pashko 2008:260).

Bitumi natyror përdoret, në radhë të parë për shtrimin e rrugëve (asfaltimi e asfalto-betonimi), për të izoluar objekte të shumëllojta nga uji, në përgatitjen e letrës e kartonit të bituminuar (të katramuar) për mbulim çatish, tulla bituminore etj.

Qytetërimet e lashta (shumerët, babilonasit, asirianët dhe egjiptianët) e kishin njohur mirë bitumin natyror dhe zbatonin teknologji të zhvilluara në përdorimet e tij. Sera përmendet edhe në përkthimin latin të Biblës: pikërisht *me serë e lyen varkën e Noes*. Në lashtësi sera është përdorur gjerësisht për izolimin e anijeve që të mos futnin ujë, për lidhjen e pjesëve prej druri, si mbulesë për ndërtesa, e përzier me disa lëndë të tjera. Është përdorur gjithashtu si lëndë lidhëse për muret (Babiloni), për balsamimin e mumieve, për zbukurimin e poçerisë neolitike me fije kashte të ngulitura në bitum.

Iliria ka qenë në lashtësi burimi kryesor i bitumit natyror në Ballkan e në Evropën Juglindore. Të gjitha të dhënat e hershme për vendburimet e bitumit në Iliri i referohen Apolonisë, e cila i vuri ato nën zotërimin e vet që në fillim të shek. V p. e. sonë. Herodoti, historian i lashtësisë përshkruan se bitumi buronte nga një vend në Iliri, që e përcakton *katër stade nga deti*, mbledhje në pellgje, kalohej në vaska prej guri e që andej në amfora. Aristoteli (shek. IV p. e. sonë) shkruan edhe për një zjarr të vazhdueshëm: *Në Apoloni ... thonë se del asfalt dhe pisë si currila që shpërthejnë nga toka ... dhe banorët thonë se jo larg këtij vendi është një zjarr, që qëndron i ndezur vazhdimisht ... Këtë del një erë squfuri dhe nishadri* (Aristoteli, 1965:42). Më pas Straboni, gjeograf grek, (shek. I p. e. sonë - shek. I e. sonë), shkruante se kish mësuar nga Poseidoni (gjeograf grek i lashtësisë), për një vend të quajtur *Nymphaneum* (Nimfe) në tokat e Apoloniatëve: *Një shkëmb aty nxjerr zjarr e po atje rrjedhin burimet e vakëta dhe asfalti. Aty pra, mbi një kodër ka një minierë ...* Edhe Plini i parë, historian romak i shek. I të e. sonë shkruante se *... aty del asfalt pisë, që është një lloj bitumi*. "Zjarri" që dilte nga shkëmbi sigurisht që ka qenë flaka e djegies së gazit natyror që shoqëron naftën dhe bitumin. Flaka e vazhdueshme ka tërhequr vëmendjen e dijetarëve të lashtësisë, sepse, aty qe edhe vendi ku sipas tyre rrinte një orakull. Kjo dukuri duket se lidhej fort me Apoloninë, sa që shfaqet edhe në një monedhë lokale argjendi, *denarë* të prerë në kohën kur kjo zonë dhe minierat e saj të çmuara të asfaltit ranë nën zotërimin e Romës, në shek. II p. e. sonë. Faqja e parë e monedhës paraqet kokën e Apolonit, perëndia mbrojtës i qytetit, kurse shpina ka orakullin, së bashku

me Nimfat (tre figura femërore valltaresh) të rrethuara nga një flakë e përjetshme zjarri natyror (Morris, 2006:94-106).

Historianët kanë shprehur mendimin se kolonët grekë e zgjodhën Apoloninë si vend ngulimi pse zona ishte e pasur njëkohësisht me lëndë drusore e me rrëshirë pishe, të domosdoshme për ndërtimin, izolimin dhe ndreqjen e anijeve; më pas edhe romakët e eksploruan këtë zonë për lëndën e drurit e rrëshirën, po për të njëjtën arsye (Wilkes 2005:146). Mirëpo, shkalla e ulët e nxjerrjes së rrëshirës nga pisha në krahasim me variantin fosil të saj (bitumin), që ishte i bollshëm, shpjegon pse burimet e mëdha të bitumit, sikurse *Nimfeumi*, tërhoqën në mënyrë të veçantë shfrytëzuesit e lashtë të Mesdheut bregdetar.

Me fillimin e kohës moderne Nimfeu është identifikuar me Selenicën, qytet rreth 30 km nga Vlora. Autoritetet venedikase dhe otomane e eksportnin bitumin nëpërmjet Vlorës, porti kryesor i eksportit drejt Evropës. Në Mesjetën e vonë, nën sundimin osman, Selenica u shfrytëzua si kurrë më parë. Tokën e saj Turqia e kishte lënë belik (pronë e shtetit). Për këtë arsye, aty erdhën e u vendosën një numër familjesh për t'u shpëtuar detyrimeve e shfrytëzimit të rëndë. Shumë udhëtarë që kaluan në këto zona i kanë përshkruar hollësisht minierat e bitumit. Udhëtari e kronisti i njohur turk Evlija Çelebi vizitoi më 1670 Vlorën. Në veprën e tij *Udhëtimet - Sejjahatnnamesi* ai ka shkruar edhe për nxjerrjen e serës në minierat e Selenicës dhe për eksportin e saj: *Në këtë vend ndodhet një minierë natyrore e mrekullueshme. Minatorët hapin gropa me kazma në mal dhe nga qindra galeri nxjerrin zift në copa të mëdha si jastëkë ose si arka. Tërë këtë mineral administratori ua shet tregtarëve frëngj, (d.m.th. evropianë perëndimorë) të cilët vijnë këtu dhe e blejnë atë në vend. Shfrytëzimi i këtij minerali bëhet me koncesion dhe i sjell thesarit shtetëror shtatëdhjetë barrë akçe, duke siguruar kështu një të ardhur kolosale për sulltanin. Punëtorët e kësaj miniere vijnë nga 20 fshatra përreth dhe janë përjashtuar nga të gjitha taksat shtetërore* (Duka 2004:14).

Albanologu dhe diplomati gjerman *Johan Georg von Hahn* ka dhënë një përshkrim të gjendjes në minierat e Selenicës, në gjysmën e parë të shek. XIX Ai shkruan se minierat ishin dhënë me qira dhe aty punonin vllehtë e fshatrave përfaqë të cilët e bartin prodhimin deri në Vlorë, prej ku eksportohej. Sera nxirrej në dy cilësi: blloqe të mëdha (këto çmoheshin së paku me dyfishin e çmimit) dhe copa të vogla. Sera në blloqe, eksportohej e gjitha në Trieste (Hahn 2008: 90). Si fillim i nxjerrjes së bitumit me punime nëntokësore njihet viti 1835. Më 1868 një studiues francez botoi të parin punim shkencor gjeologjik të vendburimeve të bitumit në Shqipëri. Ali Pasha mori nga sulltani me qira minierën, punë që më pas u ndoq nga një sipërmarrës me banim në Kostandinopojë së bashku me Ismail Qemalin. Por sipërmarrja dështoi dhe më 1875 pushteti otoman ia shiti të drejtën e shfrytëzimit të minierave shtetasit anglez Mayor, për një periudhë 75-vjeçare. Ky ia kaloi më 1880, një shoqërie të krijuar në Napoli, me emrin *Boys et Compagnie*. Më 1891 u krijua *Shoqëria e Minierave të Selenicës (Société des Mines de Selenitza)* me seli në Paris, që filloi shfrytëzimin metodik dhe e përmirësoi në mënyrë të ndjeshme leverdinë e shfrytëzimit. Eksporti vjetor luhatej nga 6 në 7 mijë tonë dhe produkti shitej me çmime mjaft të leverdishme. Kjo lidhej me famën që gëzonte bitumi i Selenicës në botë, për pastërtinë e lartë të tij, deri në rreth 87% bitum të pastër, në krahasim me 45-57% që përmbante produkti i vendeve të tjera. Bitumi eksportohej në Hamburg, Roterdam, Trieste, Odesë, Pire, Patras, Volo, Marsejë etj. Shoqëria franceze nuk u kufizua vetëm me eksportin e bitumit, por ngriti në Marsejë edhe një repart për distilimin dhe trajtimin industrial të tij (Baldacci 1929: 345). Minatorët e minierës së Selenicës ishin kryesisht fshatarë të zonave përreth, më shumë nga Treblova. Bitumi shitej në natyrë kurse transporti i tij nga Selenica në Vlorë kryhej me kafshë (me transportin merreshin 15-20 familje vllahe). Shoqëria franceze filloi ta vinte shfrytëzimin e minierës mbi baza teknike; krahas me shfrytëzimin e vendburimeve në qiell të hapur, u hapën galeri të cilat fillimisht nuk i

kalonin të 100 metrat. Në transportin e brendshëm filluan të përdoren vagonë të vegjël që bartnin deri në 300 kg secili e që lëviznin mbi shina dekovili (Myrtaj 1988: 11).

Në dekadat e para të shek. XX shfrytëzimi i minierës së serës në Selenicë i kaloi sipërmarrësve italianë (1918). Shoqëria *Societa Italiana Miniere di Selenizza, Albania (SIMSA)* ndërmori studime të gjera për bitumin, si edhe për naftën. Më 1922 kësaj shoqërie iu akordua me marrëveshje të veçantë koncesioni i minierës së serës në Selenicë dhe deri më 1926 ky ishte koncesioni i vetëm në fushën e minierave në Shqipëri (*Shqipëria më 1937*: 365). *SIMSA* trashëgoi një mol në skelën e Vlorës si dhe dekovilin Skelë - Vlorë - Penkovë, të cilën më vonë e zgjati deri në Selenicë. Shoqëria mori edhe koncesionin e një rripi toke, 1 km në secilën anë të trasesë së dekovilit. Në shfrytëzimin e minierës ajo përdori një teknikë më të zhvilluar minerare. Bitumi nxirrej nga thellësi të nëntokës, duke çelur galeri që arrinin deri në 1400-1500 metra gjatësi, si edhe puse vertikale, ndonëse shumë të ngushta e jo plotësisht të përshtatshme për ajrim; u ndërtuan edhe punime të pjerrëta të brendshme e të jashtme për transportin e sterilit të mineralit. Nxjerrja e serës në Selenicë filloi të rritet shkallë-shkallë deri sa në vitin 1931 u prodhuan 5301 tonë (Fishta dhe Toçi 1983:120). Industria e nxjerrjes dhe e pastrimit të bitumit natyror në Selenicë deri në vitin 1931 zinte vendin e parë në vlerë në industrinë minerare të Shqipërisë, ndonëse kushtet e shfrytëzimit të minierës ishin tepër të vështira. Më 1938 prodhimi arriti në 10 000 tonë (Fishta dhe Toçi 1984: 57). Pushtuesit gjermanë (shtator 1943-nëntor 1944) morën nën administrim edhe minierën e serës dhe synuan intensifikimin e prodhimit. Kështu nga 14,5 mijë tonë që u prodhuan më 1942, sipas një burimi nxjerrja e bitumit më 1943 arriti në rreth 17 mijë tonë.

Pas Luftës II Botërore vëmendje iu kushtua edhe rimëkëmbjes së minierave të serës. Gjatë luftës ishin dëmtuar rëndë shumë pajisje e impiante, dekovili Selenicë-Vlorë, dy lokomotiva etj. Miniera u rivu në shfrytëzim më 1945, vit në të cilin u bë shtetëzimi i ndërmarrjeve private italiane etj., midis të cilave edhe i *Shoqërisë SIMSA*. Në vitet e para pas luftës prodhimi u rrit shkallë-shkallë dhe arriti në mbi 14 mijë tonë (1948). Në dekadat që vijuan u intensifikuan punimet e kërkimit dhe të shfrytëzimit, duke synuar kurdoherë shtimin e mëtejshëm të prodhimit. Më 1967 u nxorën 30 500 tonë bitum natyror, por ndërkohë ishte rritur në sasi shumë herë më të madhe prodhimi në vend i bitumit të naftës (bitumi i rafinerisë, thyesi i fundit i distilimit të naftës). Lidhur me kushtet e vështira të shfrytëzimit thellë nën tokë, miniera për shumë vite, deri në fillim të viteve 1980, nuk arrinte të realizonte prodhimin e parashikuar si dhe treguesit ekonomikë të planifikuar. Një përfitim të rëndësishëm pati miniera në këtë kohë nga vlerësimi që iu bë zhavorrit bituminoz (lëndë e djegshme midis bitumit e qymyrgurit) që nxirrej aty. Deri atë kohë aty përdoreshin sasi të vogla të tij për shkrirjen e bitumit, si dhe për vënien në lëvizje të lokomotivës së linjës hekurudhore Selenicë-Vlorë. Gjatë viteve 1980-të zhavorri bituminoz (*skërkalla*) u bë produkt kryesor për minierën, sidomos me futjen e tij në përdorim në Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit, për prodhimin e kokut për metalurgjinë me ngjyrë, gjithashtu edhe në fabrikën e pasurimit të qymyreve në Valias (Tiranë). Por, pas vitit 1990, lidhur me ndryshimin e sistemit politik e ekonomik në vend, prodhimi në minierën e Selenicës ra në mënyrë të konsiderueshme deri pothuaj në ndërprerjen e tij (Guxho, 2008:1724). Më 1996 pjesa kryesore e minierës u privatizua dhe kaloi në pronësi të një investitori vendës.

Me fillimin e shek. XXI shënohet një rikthim i interesit francez për bitumin e Selenicës. Një grup francez, *France KLP Mines* mori më 2001 koncesionin e minierës dhe themeloi si degë të tij shoqërinë *Selenicë Bitumi sh.a.* Kjo shoqëri rifilloi punimet për të bërë të mundur një shfrytëzim minerar në shkallë të gjerë. Bitumi natyror i ngurtë nxirret aty kryesisht me punime të hapura, por është e mundshme edhe me punime nëntokësore; përmbajtja e bitumit në mineralin që nxirret është mbi 80%. Pasi nxirret ai thyhet e pastrohet, pastaj kalon në furra për t'u shkrirë dhe lënda e

zezë veshtullore që përfitohet derdhet në forma gjashtëkëndëshe prej hekuri. Blloqet që formohen, më pas thërrmohen e bluhën deri në përmasa të ndryshme e ambalazhohen sipas kërkesave të përdoruesve. Produkti *Selenicë Bitumi sh.a.* vazhdon të furnizojë qytetet e botës me një komponent të çmuar që përdoret për shtrimin e rrugëve, si edhe me kimikate që prodhohen mbi bazën e bitumit. Produkti shitet në varësi të sigurimit të tregjeve në Francë, Zvicër, Itali, Greqi e Ukrainë, e deri në Kinë, Kanada e vende të Afrikës Veriore. Në dhjetëvjeçarin e dytë të shek. XXI nxjerrja e bitumit në Selenicë vlerësohej në 8-10 mijë tonë në vit që eksportohej. Përveç kompanisë franceze aty veprojnë sipërmarrës vendorë që nxjerrin zhavorr bituminoz e rërë bituminoze. **Dh.H.**

Bibliografi:

Aristoteli: *Mbi mrekullitë e dëguara*, në *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë: te autorët antikë: Ilirët dhe Iliria*, vëll. I, Tiranë 1965.

Hahn (von), J. G.: *Albanesische Studien*, Jena 1854; *Studime shqiptare*, Tiranë 2008.

Morris S.: *Illyrica Pix: the exploitation of bitumen in ancient Albania*, në *New directions in Albanian Archaeology*, Tiranë 2006.

Baldacci, Antonio: *L'Albania*, Roma 1929.

Wilkes J., *Ilirët*, Tiranë 2005.

Ceka, Neritan: *Apolonia e Ilirisë*, Tiranë 1982.

Diamanti, F., Pashko, G.: *Bitumi*, në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, v. 1, Tiranë 2008.

Duka Ferit: *Fasada bregdetare e Shqipërisë osmane, qyteti i Vlorës gjatë shek. XV-XVII*, në *Studime Historike*, nr 3-4, Tiranë 2004.

Fishta Iljaz, Toçi, Veniamin: *Ekonomia e Shqipërisë në vitet e para të ndërtimit socialist (nëntor 1944 - nëntor 1948)*, Tiranë 1984.

Fishta I., Toçi V.: *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944*, Tiranë 1983.

Guxho S.: *Miniera e Selenicës*, në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II, Tiranë 2008.

Myrtaj, F.: *Miniera 2000-vjeçare e Selenicës*, në *Shkenca dhe jeta*, nr. 1, 1988.


Shqipërija më 1937, vëll. II, Tiranë 1938.



Miniera e Selenicës (1905)



Reparti i shkrirjes së bitumit



Dekovili për transportin e bitumit në portin e Vlorës (rreth 1916-1918)



Miniera sipërfaqësore e bitumit natyror (Selenicë, 2013)



Transporti i bitumit të paketuar me automjete e avionë mallrash

Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)

Artikull i madh, 19333 shenja, përgatiti Marenglen Verli

Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881), organizata e parë politiko-ushtarake mbarëshqiptare dhe më e rëndësishmja, me frymëzim patriotik, që u përpoq të zbatonte programin e Rilindjes Kombëtare. U themelua në Prizren më 10 qershor 1878, në kushtet e acarimit të *Krizës Lindore* të viteve 70-të të shek.XIX (1875-1878), kur Perandorisë Osmane, pas humbjes së luftës me Rusinë dhe nën tryshninë e Fuqive të Mëdha, iu imponuan lëshime territoriale në Ballkan. LSHP mori përsipër të zgjidhte tri detyra themelore të shqiptarëve: a) të afirmonte në arenën ndërkombëtare kombin shqiptar si subjekt të të drejtave kombëtare; b) të kundërshtonte copëtimin e trojeve etnike shqiptare vendosur në *Kongresin e Berlinit*; c) të realizonte bashkimin e trojeve etnike shqiptare në një formacion shtetëror autonom në kuadër të supershtetit osman si hap i parë për të krijuar shtetin shqiptar të pavarur (FESH, 2008: 1512).

Deri në prag të LSHP shqiptarët kishin zhvilluar një varg kryengritjesh antiosmane, por përgjithësisht ato nuk orientoheshin nga kërkesa kombëtare, sepse Porta e Lartë nuk pranonte asnjë kërkesë të tillë. Edhe Fuqitë e Mëdha nuk kishin pranuar t'u njihnin shqiptarëve të drejtën e formimit të shtetit të tyre, duke përfshirë edhe vitet e *luftës ruso-osmane* të viteve 1877-1878, kur fitorja e Rusisë dukej qartë. Shqetësimi i shqiptarëve arriti kulmin me nënshkrimin e *Traktatit të Shën Stefanit* (mars 1878), sipas të cilit Rusia i shkëputte Perandorisë Osmane mjaft vise shqiptare në favor të Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Në krye të protestave popullore që shpërthyen në mbarë viset shqiptare kundër këtij Traktati u vu *Komiteti i Stambollit (Komiteti Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare)*, krerët e të cilit: *Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Ymer Prizreni, Zija Prishtina, Ahmet Koronica, Iljaz pashë Dibra, Jani Vreto, Sami Frashëri* etj., shpalosën në faqet e shtypit europian dhe në selitë diplomatike të Fuqive të Mëdha platformën e të drejtave kombëtare të shqiptarëve dhe vendosmërinë e tyre për t'i realizuar me çdo kusht këto kërkesa (Frashëri, K., 2012:193).

Traktati i Shën Stefanit binte ndesh edhe me interesat e Fuqive të Mëdha në rajon. Në *Kongresin e Berlinit*, që u mbledh më 13 qershor 1878, ato kërkuan rishikimin e vendimeve të tij. Por edhe në këtë forum Fuqitë e Mëdha nuk i morën parasysh të drejtat kombëtare të shqiptarëve. Ato ia shkëputën Bullgarisë territoret e premtuara shqiptare, por nga ana tjetër i premtuan Greqisë (me *protokollin 13*) aneksimin e viseve shqiptare të Çamërisë deri në lumin Kalama (LSHP në dok. a-h, 2008:350).

Duke parashikuar qëndrimin jodashamir të Fuqive të Mëdha ndaj shqiptarëve, tri ditë para se të mblidhej Kongresi i Berlinit, me nismën e Komitetit të Stambollit, me delegatë të ardhur nga mbarë krahinat shqiptare, u mbledh në Prizren, nën kryesinë e Iljaz pashë Dibrës, më 10 qershor 1878, Kuvendi Kombëtar, që shpalli themelimin e *Lidhjes Shqiptare*, të njohur me emrin *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*. Organi më i lartë i LSHP ishte *këshilli i përgjithshëm* me 56 anëtarë (kryetar Iljaz pashë Dibra), me funksione legislative, i cili krijoi nga ana e vet Komitetin Kombëtar (*komitetin për shpëtim publik*) me 13 anëtarë (kryetar Ymer Prizreni), të pajisur me pushtet ekzekutiv, për të drejtuar veprimtarinë e përditshme të saj. Komiteti kishte tre komisione me funksione dikasteriale: për punët e jashtme (kryetar *Abdyl Frashëri*), për punët e brendshme (kryetar Haxhi Shaban Prizreni), për çështjet financiare (kryetar *Sulejman Vokshi*). Për të lehtësuar veprimtarinë e saj në terren Komiteti Kombëtar krijoi tri hallka të mëdha administrative (nënkomitete ndërkrahinore) në tre vilajete: a) për të përballuar rrezikun

që vinte nga synimet serbe (nënkomiteti i Prizrenit); b) malazeze (nënkomiteti i Shkodrës) dhe c) greke (nënkomiteti i Janinës). Pranë nënkomiteteve u krijuan tre shtabe ushtarake ndërkrahinore, të kryesuar respektivisht nga *Ali beg Gucia*, *Hodo beg Sokoli*, *Nuredin M. Vlora*. (FEK, 2018:976; Frashëri, 2012: 232-233).

LSHP u krijua në kushtet që lëvizja kombëtare shqiptare ishte ende e paqartë, prandaj që në ditët e themelimit u dukën ndikimi dhe presioni i Portës së Lartë dhe i elitës shqiptare të afërt me të (Abdulla pashë Dreni, Sadik pashë Hoxholli, Abdurrahman pashë Shkupi, Mehmet Zijai - Prishtina) sheh Mustafa Tetova, Iljaz pashë Dibra, Jashar bej Shkupi, Hamdi Shaban Peja, Sadik pashë Tetova, Ahmet Sabri Karahasani, Ali pashë Draga etj.), të cilët bënë çmos që ajo të pajisej me programin e një organizate fetare myslimane, të bindur ndaj sulltanit sovran, dhe të merrte përsipër që të mbronte gjithë territoret ballkanike të banuara edhe nga myslimanë joshqiptarë. Këtij presioni, që pati efekt në *Karar-namenë* (vendimet), e miratuar më 17 qershor 1878, Këshilli i Përgjithshëm i bëri ballë duke miratuar dy javë më vonë, më 2 korrik 1878, një statut (*Kanun-namenë*) me karakter dhe me program më të përparuar kombëtar. Kanuni i jepte të drejtë LSHP të kishte administratë, ushtri, buxhet dhe gjyqe të veçanta. Lidhja u vesh kështu me funksione pushtetore e u pajis me prerogativat në embrion të një shteti shqiptar brenda shtetit osman (FESH, 2008: 1514; Frashëri, 2012: 250).

Vendimet e Kongresit të Berlinit, të cilat cenonin territoret etnike shqiptare, shkaktuan zemërimin e popullsisë shqiptare jo vetëm kundër Fuqive të Mëdha, por dhe kundër Portës së Lartë. Në fund të gushtit 1878 i dërguari i posaçëm i sulltanit *Mehmet Ali pasha*, i njohur nga shqiptarët me nofkën *Maxhari*, me detyrën që të kryente në përputhje me vendimet e Kongresit të Berlinit formalitetet e dorëzimit të Plavës dhe Gucisë te autoritetet e Malit të Zi, u prit me protesë. I dërguari i sulltanit nuk i mori në konsideratë kërkesat e krerëve të LSHP për të hequr dorë nga misioni i ngarkuar. Pasi nuk pranoi të kthehej mbrapsht, ai u rrethua nga disa mijë vullnetarë të Lidhjes në Gjakovë më 3 shtator 1878, në sarajet e Abdulla pashë Drenit, ku ishte strehuar. Në përfundim të ultimatumit prej 24 orësh, forcat e LSHP hapën zjarr kundër sarajeve ku ndodhej Maxhar pasha nën mbrojtjen e qindra forcave osmane. Luftimet vazhduan deri më 6 shtator dhe përfunduan me vrasjen e Mehmet Ali pashës, Abdullah pashë Drenit dhe të shumë shoqëruesve e mbrojtësve të tyre (Frashëri, 2012: 302-320).

Më 1 nëntor 1878 u thirr në Dibër një mbledhje tjetër e LSHP, që miratoi një rezolutë me të cilën kërkohej nga Porta e Lartë bashkimi i të gjitha krahinave shqiptare në një vilajet të vetëm, të pajisur me një autonomi administrative nën sovranitetin e sulltanit; krijimi i një kuvendi të përgjithshëm (parlamenti), si organi më i lartë legjislativ; njohja e gjuhës shqipe nga nëpunësit e vilajetit; futja e mësimi shqip në shkollat e vendit; mbulimi financiar i rrejtësve sipas buxheti i vilajetit etj. Kuvendi vendosi që rezoluta të paraqitej për miratim nga një delegacion prej 14 anëtarësh, të zgjedhur nga 14 sanxhakët e viseve shqiptare. Por delegacioni i ngarkuar me këtë detyrë, i kryesuar nga Iljaz pashë Dibra dhe Abdyl Frashëri, u detyrua të pezullonte misjen, pasi kishte lindur rreziku i zbatimit të *protokollit 13* të Traktatit të Berlinit, që parashikonte aneksimin e Çamërisë nga Greqia. Nënkomiteti ndërkrahinor i LSHP për vilajetin e Janinës, në janar 1879, e shtoi një veprimtarinë kundërshtuese. Në këtë kohë aty u mbledh komisioni dypalësh greko-osman për të caktuar vijën e re të kufirit sipas marrëveshjes për ndarjen e tokave shqiptare. Nënkomiteti i LSHP reagoi me një varg demonstratash, duke kërkuar që Greqisë t'i jepeshin territore greke në Thesali dhe jo troje shqiptare të Çamërisë. Protestat dhanë rezultat. Komisioni turko-grek i ndërpreu punimet për t'i rifilluar më vonë. Pas këtij sukse si LSHP nisi në një mision diplomatik dy nga krerët e saj, *Abdyl Frashërin* dhe *Mehmet Vrionin*, për të bindur kancelaritë e mëdha europiane që të ndryshonin përmbajtjen e *protokollit 13*, përndryshe, siç theksonin ata, do të shkaktohej gjakderdhje mes grekëve e shqiptarëve. Delegacioni u nis për në Europë në fund të

prillit 1879 dhe vizitoi kryeqytetet e pesë Fuqive të Mëdha: Romën, Parisin, Londrën, Berlinin dhe Vjenën. Delegatët e LSHP u dorëzuan ministrave të jashtëm të pesë Fuqive të Mëdha një memorandum, me të cilin kërkonin që shqiptarët të trajtoheshin ashtu siç ishin, si një komb më vete, dhe që ato fuqi të hiqnin dorë nga politika e copëtimit të tokave shqiptare. Në fund të misionit ata arritën t'i bindnin shefat e diplomacive të tyre që të mos nguteshin në zbatimin e *protokollit 13* (FESH, 2008: 1515).

Fuqitë e Mëdha, në shkurt 1879, nën presionin e Rusisë, e detyruan Turqinë t'ia dorëzonte Malit të Zi krahinat e premtuara në Taktatin e Berlinit. Porta e Lartë i tërhoqi ushtritë nga ato vise. Ushtritë malazeze hynë pa pengesa në Podgoricë, Shpuzë dhe Zhabjak, por në Plavë e Guci gjetën ushtritë e LSHP, të cilat kishin arritur para tyre dhe qenë përgatitur për rezistencë. Me urdhër të princ Nikollës, ushtritë malazeze, nën komandën e *Mark Milanit*, më 4 dhjetor 1879 shpërthyen një sulm të furishëm në drejtim të Plavës. Ushtritë e LSHP, të komanduara nga Ali beg Gucia, u përgjigjën me luftë. Repartet e saj, të udhëhequra nga prijësi popullor *Jakup Ferri*, e përballuan me sukses sulmin dhe u shkaktuan malazezëve një disfatë të rëndë, duke i detyruar të tërhiqeshin. Më 7 janar 1880 rreth 12 mijë ushtarë malazezë, të rreshtuar në vijën kufitare Pepaj-Nokshiq-Arrzhanicë, prisnin urdhrin e sulmit nga princ Nikolla. Por këtë radhë nismën e morën vetë forcat shqiptare. Luftëtarët e LSHP u hodhën në sulm të përgjithshëm kundër tyre. Në *betejat e Nokshiqit* dhe të *Pepajt* (8 janar 1880), forcat malazeze pësuan disfatë të thellë (Frashëri, 2012: 390-423).

Më 12 prill 1880, ambasadorët e Fuqive të Mëdha në Stamboll, vendosën që në vend të Plavës e Gucisë, Malit të Zi t'i jepeshin viset e Hotit dhe të Grudës, duke i lënë Portës së Lartë dhjetë ditë kohë për të kryer dorëzimin e tyre. Megjithatë viset e Hotit e të Grudës bënë pjesë në vilajetin e Shkodrës, barrën për të kundërshtuar shkëputjen e tyre e mori përsipër komisioni ndërkrahinor i LSHP i këtij vilajeti. Më 17 prill, pas një mitingu proteste që u mbajt në Shkodër, kryetari i shtabit ushtarak të LSHP për këtë vilajet, Hodo beg Sokoli, u nis nga Shkodra në krye të vullnetarëve shqiptarë dhe u vendos në Tuz, pranë vijës kufitare. Edhe këtë radhë sulltani, për të mos shtuar zemërimin e shqiptarëve, por edhe për të sfiduar indirekt Fuqitë e Mëdha, nuk mori asnjë masë kundër tyre. Në afatin e caktuar, më 22 prill, ai tërhoqi ushtrinë nga vija kufitare. Forcat e Lidhjes, që ndodheshin në Tuz, zunë menjëherë pozicionet e tyre. Kur ushtritë malazeze shkuan për të marrë në dorëzim Hotin dhe Grudën, u ndeshën me repartet e LSHP të Ura e Arrzhanicës. Vendosmëria e shqiptarëve në *betejën e Arrzhanicës* i detyroi forcat malazeze të tërhiqeshin (Frashëri, 2012: 423-454).

Pasi u pa se shqiptarët nuk do të lëshonin pa luftë as Hotin me Grudën dhe pas bisedimeve që zhvilluan midis tyre gjatë qershorit, Fuqitë e Mëdha vendosën që ta detyronin Turqinë që në vend të tyre t'i jepte Malit të Zi qytetin bregdetar të Ulqinit së bashku me rrethin, të banuara edhe këto me popullsi krejtësisht shqiptare. Këshilli i LSHP vendosi ta kundërshtonte me armë dorëzimin e Ulqinit. Barrën e mbrojtjes e mori përsipër komisioni ndërkrahinor për vilajetin e Shkodrës (FESH, 2008: 1515). Në këto kushte te qarqet patriotike përparimtare u forcua bindja se e vetmja rrugë për të larguar rrezikun e copëtimit të trojeve shqiptare ishte formimi i një vilajeti shqiptar autonom, me integritet territorial të njohur nga Porta e Lartë. Për të trajtuar këtë çështje më 24 korrik 1880 u mbledh *kuvendi i Gjirokastrës*, që vendosi t'i parashtrohej Portës së Lartë kërkesa e formimit të një Shqipërie autonome *me hirin* (pëlqimin) e sulltanit dhe, nëse sulltani nuk do të pranonte, autonomia të realizohej *pa hirin* e tij (Frashëri, 2012: 518).

Ndërkohë çështja e Ulqinit erdhi duke u ndërlikuar. E zënë ngushtë, Porta e Lartë bëri përpjekje të mëdha për t'i bindur shqiptarët që të hiqnin dorë nga rezistenca, por nuk ia arriti dot. Në shtator, sapo ushtria osmane u largua nga Ulqini, forcat e vullnetarëve shqiptarë e shtinë në dorë qytetin dhe deklaruan se do ta mbronin atë me çdo kusht. Disa ditë më vonë (20 shtator

1880) mbërriti në afërsi të Ulqinit një flotë ndërkombëtare prej 17 luftanijesh. Komandanti i flotës u dha ultimatum vullnetarëve shqiptarë ta dorëzonin qytetin brenda tri ditëve, por mbrojtësit nuk u lëkundën. Në situatën e krijuar, zemërimi i shqiptarëve arriti kulmin. Krahut radikal i LSHP mendoi se ishte koha për të vënë në jetë programin autonomist. Më 20 tetor 1880 u mbledh në Dibër *kuvendi i përgjithshëm* i LSHP, në të cilin merrnin pjesë rreth 300 delegatë nga të dy rrymat. Patriotët e krahut radikal, të kryesuar nga Abdyl Frashëri, parashtruan programin e tyre të përmbledhur në tri pika: të mbrohej me çdo kusht Ulqini duke luftuar edhe kundër ushtrive osmane; të miratohej një rezolutë ku t'i kërkohej sulltanit në mënyrë kategorike autonomia e Shqipërisë; në rast se sulltani refuzonte, të kalohej menjëherë në aksion duke formuar qeverinë e përkohshme shqiptare. Delegatët e rrymës së moderuar e kundërshtuan në parim këtë platformë, sidomos qëndresën e armatosur për mbrojtjen e Ulqinit. Ata qenë gjithashtu kundër formimit të qeverisë së përkohshme, të cilën e cilësuan si një akt rebelimi ndaj Portës. Për sa i përket çështjes themelore, ata qenë në parim për krijimin e një vilajeti autonom shqiptar, por këtë donin ta realizonin jo me luftë, por me hirin (pëlqimin) e sulltanit.

Si pasojë e këtyre divergjencave, nga kuvendi dolën dy rezoluta: rezoluta e krahut radikal fitoi afërsisht 130 vota, rezoluta e pjesës së moderuar 150 vota. Të dyja rezolutat u dërguan me delegacione të veçanta në Stamboll. Porta e Lartë e zvarriti përgjigjen. Ajo nuk pranoi të merrte në konsideratë asnjë nga të dyja rezolutat dhe vendosi të përdorte ushtrinë kundër LSHP për t'i dorëzuar Ulqinin Malit të Zi. Në nëntor 1880, pasi arritën përf forcime të reja, komandanti turk Dervish pasha, në krye të 20 batalioneve, filloi marshimin kundër Ulqinit. *Mbrojtja e Ulqinit* (1880) u bë nga 3 mijë vullnetarë. Në sajë të epërsisë ushtarake, Dervish pasha e theu më në fund qëndresën e shqiptarëve dhe më 26 nëntor 1880 ua dorëzoi Ulqinin malazezëve, në prani të flotës ndërkombëtare (Frashëri, 2012: 585-616).

Pakënaqësia e krijuar me dorëzimin e Ulqinit krijoi kushte të favorshme për LSHP për ta realizuar vetë autonominë e Shqipërisë. Në dhjetor 1880 aktivistët radikalë të LSHP shtinë në dorë pushtetin në mjaft krahina të Kosovës duke larguar administratën perandorake. Në valën e këtyre veprimeve u krye një riorganizim i LSHP, duke lënë jashtë saj elementët që s'u pajtuan me këtë kthesë. Në janar 1881 *komiteti kombëtar* i LSHP e shpalli veten *qeveri e përkohshme e Shqipërisë*, me kryetar Haxhi Ymer Prizrenin, që ishte dhe kryetar i Lidhjes shqiptare. Nën kryetar u zgjodh *Shuaip Spahiu* dhe anëtarë Abdyl Frashërin, *Sulejman Vokshin* e të tjerë. Brenda pak javëve ajo e shtriu autoritetin e vet në pjesën më të madhe të vilajetit të Kosovës, përfshirë edhe qytetin e Shkupit. Filloi kështu realizimi i autonomisë së Shqipërisë (FESH, 2008: 1517).

Me gjithë këto suksese, qeveria e LSHP nuk i largoi garnizonet e ushtrisë osmane, por i la brenda kazermave të tyre. Porta e Lartë nuk ndërhyri menjëherë për ta shuar lëvizjen autonomiste, pasi ato javë qeveria greke rifilloi presionin për shpëputjen nga Perandoria Osmane të viseve të premtuara nga Kongresi i Berlinit. Me ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha u pranua që në vend të Çamërisë Greqia të aneksonte Thesalinë. Porsa u nënshkrua marrëveshja, Porta e Lartë, më 25 mars 1881, nisi në drejtim të Shqipërisë një ekspeditë të fortë ushtarake prej 40 batalionesh (20 mijë ushtarë) nën komandën e Dervish pashës për ta shtypur lëvizjen autonomiste shqiptare. Pasi e shtiu në dorë me tradhti Shkupin, ushria osmane hyri në Kosovë. Qeveria e LSHP u përgatit për mbrojtje, por në kohën kur ajo do të ndeshej me ushtrinë osmane, prapa krahëve filluan goditjet e garnizoneve osmane të Kosovës. Si rrjedhim, qeveria e Lidhjes nuk qe në gjendje ta ndalte marshimin e Dervish pashës. Ushtritë e saj, të udhëhequra nga Sulejman Vokshi, me gjithë rezistencën heroike, u thyen më 20-21 prill 1881 në *betejën e Shtimes dhe të Slivovës*. Ushtritë osmane e patën të lehtë t'i asgjësonin pritën e mëtejshme dhe më 24 prill hynë në Prizren. Rezistenca vazhdoi më tej në Malësinë e Gjakovës për disa javë, por e paorganizuar, dhe në mes

të muajit maj 1881 u shtyp. Bashkë me të u likuidua edhe qeveria e përkohshme. Në vilajetin e Kosovës u rivendos administrata ushtarake osmane, e cila ndërmori menjëherë një fushatë persekutimesh kundër veprimtarëve të LSHP. Me mijëra vetë u burgosën e u internuan. Udhëheqësit e Lidhjes që nuk pranuan të kërkonin ndjesë për pikëpamjet e tyre autonomiste, pësuan dënime të rënda. Haxhi Ymer Prizreni shpëtoi ngaqë mërgoi në Mal të Zi, Sulejman Vokshi nuk u arrestua pasi u fsheh për disa vite (deri më 1885) në Malësinë e Gjakovës, Shuaip Spahiu u vra si shumë të tjerë pa gjyq, kurse Abdyl Frashëri, i cili u arrestua me tradhti, u dënua me burgim të përjetshëm (Frashëri, 2012: 663).

LSHP zë vend të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë. Ajo është organizata e parë patriotike që mori përsipër të organizonte luftën për çlirimin e atdheut dhe formimin e shtetit kombëtar; e para organizatë që grumbulloi në gjirin e vet të gjithë shqiptarët, pavarësisht nga përkatësia fetare, krahinore dhe shoqërore; e para organizatë që kombinoi për interesa kombëtare lëvizjen e armatosur me aksionin diplomatik dhe me veprimtarinë kulturore; e para organizatë patriotike që gërshetoi qëndresën kundër Fuqive të Mëdha, Perandorisë Osmane dhe monarkive fqinje për të mbrojtur tërësinë tokësore të atdheut dhe për të realizuar autonominë e Shqipërisë. **M.V.**

Bibliografi:

Frashëri, Kristo: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit* (1978-1881), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2012.

Puto, Arben: *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit* (përmbledhje dokumentesh dhe vështirime historik), I, Tiranë 1984.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar (FESH), vëll. II, Tiranë 2008.

Fjalori Enciklopedik i Kosovës (FEK), vëll. II, Prishtinë 2018.

Frashëri, Mehdi: *Lidhja e Prizrenit dhe efektet diplomatike të saj*, Tiranë 1938.

Akte të Rilindjes Kombëtare (1878-1912), bot. Instituti i Historisë, përg. nga S. Pollo e S. Pulaha.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane (1878-1881), përg. nga K. Prifti, Tiranë 1978.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane (1878-1881), përg. nga I. Rexha, Prishtinë 1978.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze (1878-1881), përg. nga S. Rizaj, Prishtinë 1978.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze, Librat I, II, përg. nga R. Abdyli, Prishtinë 2004.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1978), vëll. I, përg. nga B. Meta, F. Duka, M. Verli, Prishtinë 2008.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878-1879), vëll. II, përg. nga M. Verli, Prishtinë 2018.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1879-1880), vëll.III, përg. nga B.Meta, Prishtinë, 2018.

Artikull i madh, 9882 shenja, përgatiti Sabri Hamiti

Anton Pashku është nga autorët e parë të letërsisë moderne shqipe. Lindi më 1 janar 1937 në Grazhdanik të Prizrenit; vdiq më 31 tetor 1995 në Prishtinë dhe prehet në Karashëngjergj të Hasit. Shkollën fillore e kreu në Prizren, gjimnazin në Prishtinë (1958). Punësohet në shtëpinë botuese *Rilindja* më 1959, ku punoi deri në fund të jetës si gazetar, redaktor botimesh e revistash.

Veprat kryesore letrare të A.P. janë: *Tregime* (1961), *Nji pjesë e lindjes* (1965), *Kulla* (1968), *Sinkopa* (1969), *Oh* (1971), *Kjasina* (1973), *Gof* (1976), *Lutjet e mbrëmjes* (1978), *Tragjedi moderne* (1982). Vepra e tij complete përbëhet nga *Tregime fantastike* (1986), *Oh* (1986), *Tragjedi moderne* (1986) dhe *Galtina* (2005). Nga tregimi i parë (*Në gjiri*, 1955) deri te tregimi i fundit (*Bejta*, 1989) veprat letrare i botoi te *Rilindja*.

Procedu letrar i A.P. shfaqet nësoj në format e prozës dhe në format dramatike. Perspektiva dhe retrospektiva *narrative* bëhet e ngjashme me perspektivën dhe retrospektivën teatrale, *dramatike*. Çrëndomtësimi i formave klasike rëndomtëson format moderne. Ky proces krijues artikulohe me gjuhën e figurës së kulluar në rrëfim, në dëftim e në dramë, me status të gjuhës poetike. Pasoja rinjeh shkakun, ashtu si retrospektiva ringjall prospektivën, duke bërë lojën me kohën si lojë të spontanitetit krijues, dhe tematikat universale nga e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja. Baza e historisë rigjen pamjen në bashkëkohësi. Identitarja lidhet me universalen, individualja ndeshet me kolektiven kanonike, individi me sistemin. Temat e pasioneve humane, duke kaluar nëpër sprovat e modernitetit, artikulojnë nësoj thellësisht egërsinë e bestialitetin përballë ndjesisë dhe melankolisë njerëzore. Temat: dashuria, egërsia, pasioni, mundimi, dhembja, maskat, qëndresa, lakohen në variante te tregimet *Nën qarr po rrinte vasha*, *Kënaqësitë e megalopolisit*, *Disa fjalë për një plak e librin e tij kushtuar tymit*, *Anija e dehur*, *Kulla*. Vëmendja bie mbi kryeveprën tregimtare të Pashkut, *Kulla*, në të cilën tematizohet qëndresa e identiteti kombëtar dhe në romanin *Oh*, kryeveprën e autorit, në të cilin tematizohet bota shqiptare nga tragjedia ilire deri te projeksionet distopike.

Tregimi *Kulla* ka epigrafin *Sipas një stenogrami, por të padeshifruar plotësisht*, që dëshmon një tip shkrimi mbështetur në dokumentin e autenticitetit, duke zhvilluar markën e mjeshtërisë letrare. Makrotema është qëndresa fizike dhe qëndresa kulturore shqiptare deri në flijim. *Dje e varrosëm plakën, kurse tash jam i etur*, nis tregimi, për të shpalosur deshifrimin poetik të stenogramit, thurjen e kallëzimit tronditës për kullën ndërmjet plakës shamizezë dhe kasapit të katundit që pret Bardhoken e vjedhur. Ky dialog del i qartë me gjuhë të egër e kërcënime të këtij ballafaqimi, i shqiptuar nga figura ambientale dhe autentike. Kasapi, që është i huaj, kërcënon vendësit se duhet të hanë veten. Plaka mbrohet duke mbrojtur kullën në emër të jetës. *Kulla* kërcënohet nga *Kjasina* për t'u bërë *Galtinë*. Këto janë figurat, që janë identike me tituj veprash të autorit A.P., i cili përjetëson qëndresën kulturore. Varrosja e plakës është mision i mbaruar, pas bartjes së kujtesës kulturore te deshifruesi, dëshmitari dhe autori që shton dëshminë e vet letrare: *Më duket se është afër agu. Errësira nuk është e dendur si më parë*.

Kulmi i inteligjencës krijuese të A.P. kurorëzohet në kryeveprën e tij, romanin *Oh*, që është amëza e metodës së tij krijuese, për veprat e të gjitha gjinive: për gjuhën e figuruar poetike, për strukturën artistike, për domethënien humane. Vepër e thurur në mes pësimit e mësimit, *Oh* në dy retrospektiva zbret deri në antikë, me gjithë kumtin tragjik të Ilirisë, për t'u ngjitur në kohë deri në formën rrëqethëse të distopisë. Kjo është bota autentike që dëshmon kumtet e kaluara dhe

kërcënimet e pritshme. Tragjedia e ilirëve në luftën kundër Romës, në vitet 6-9 të epokës sonë, vjen e rrëfyer nga gojët e disfatistëve ilirë, e shkaktuar nga tradhtia dhe lufta për pushtet. Kjo është e parë edhe më thellë në humbjen e Gentit të Scodra. *Oh*, si klithje e dhembjes, nuk mund të bëhet jehonë e marrëveshjes, duke qenë lajm i zi i humbjes së tradhtisë. Kjo tematikë përcillet me seksione të figurave me mesazhe të frikshme dhe në kohët e mëvonshme. Tragjikja merr dimensione të reja në retrospektivën e dytë që artikulohet në trajtë të utopisë negative për të ardhmen, duke u shndërruar në propagandë ideologjike të totalitarizmit. Mizogami ligjëron urrejtjen e familjes autentike për të përqafuar çatinë e Kozmosit në vend të Votrës, dhe pëlqen fëmijët pa familje në emër të kozmopolitëve. Kjo është shtresa thelbësore e tekstit, ku funksionon ironia autoriale deri në nivel të përmbysjes totale, edhe në trajtë të satirës. Predikuesi i madh flet për përmasa të zhvillimeve katastrofike, për të parë përleshjet të mjerët që lëngojnë, duke thurur kultin e individit, për të prodhuar një *karrige* pushteti. Ligjërimi letrar i A.P. këtu është i ngjashëm me ligjërimin distopik të Zamjatinit në veprën *Ne*, dhe të Oruellit në veprën *1984*. Romani *Oh* mbyllet me përsëritje, të lojës së fjalëve ndërmjet Mashkullit e Femrës, që pëlqehen në forma dhe përjashtohen në kuptime. Kjo është një litotë autoriale për mosmarrëveshje ndërmjet medimit historik të Mashkullit dhe ëndrrës për *kullën në zall* të Femrës. Kjo vepër ka në brendi porosi të urtisë dhe humor të zi.

Shkrimtari A.P. bëhet personal dhe krejt bashkëkohor me dy prozat e fundit: *Aventurat e tezes* (1982) dhe *Betja* (1989), që të lidhura "parashohin" amëzën e një romani të pambaruar, pandan të *Oh*-ut. Prapë është në sprovë Votra me Botën, Qendra me Periferinë, krijuesi kundër dhunuesit. Megaideologjia njih vetëm dhunën, edhe kur deklaron lirinë e individit. Është ballafaqim i të voglit me të madhin, duke ironizuar barazinë. Autori ndien mëkatën për Beten e vet, shpëtimtaren, figurën e Ujit të Mirë, porse nuk e merr bekimin e kërkuar nga Kardinali, që bëhet Papë. Rrëfimi i shtegtimit imagjinar nga Varshava nëpër Pragë për në Ujin e Mirë, është një dëshpërim sepse i thonë që autor i Gernikës nuk është Pikaso, por është Gjenerali Franko! Edhe miku i tij në Pragë, Kafka, i tha "kur nuk ka eksplozione ka implozione". Në fund mbetet Betja si shpëtimtare, që dëshmon virginitetin. Murgu letrar A. P. me prozat e fundit fantastike dhe figuracionin e pasur që lidhet në segmente kohe e fragmente të numerizuara matematike, kurorëzon Biblën e vet letrare dëshmitare të kohëve e civilizimeve.

Dy dramat e A.P., *Gof* dhe *Sinkopa*, kanë strukturë dhe teksturë të ngjashme: figuracion, personazhin si aktant, paraqitjen e gjendjes pa ndodhi, e dilemës pa zgjidhje. *Me shkue a me mbetë*: situata paralele simbolike në trajtë të antidramës si tragjedi moderne. Në dramën *Gof*, që paraqet pushtimin e Shqipërisë në prillin e 1939-ës, aktantët janë të mbërthyer nga furtuna, në një krizë shoqërore dhe ekzistenciale. Lulua, Lulani e Lulashi paraqesin grindje të personazhit të dezintegruar, kur kërkojnë shtegdalje. Lulashi tashmë është viktimë dhe në sololokuium belbëzon gjendjen katastrofike në kryeqytetin provincial, Tiranë. Lulua i dehur heziton të lëvizë. Lulani kërkon mënyrat për të dalë nga kriza. Çintegrimi i personazhit në aktantë e bën gjendjen të pazgjidhshme. Një zgjidhje simbolike e jep autori me "rrotullimin e gurit të mullirit që bluan drithë". Një dalje, qoftë si projeksion utopik, provohet në dramën *Sinkopa*, që paraqet një kohë të mëvonshme të mbërthimit në kataklizmën e dominimit teknologjik dhe ideologjik si rrjet merimange, që do të zotërojë Dheun e Kozmosin. Xhexheu në komunikim me alteregon e tij Gjegjeun, nuk arrin më larg sesa vetëdijesimi se Lumnija dhe Lumtuni qoftë si ide, qoftë si krijesë letrare, kanë humbur dhe nuk mund të gjenden as në Atlantidë si ujdhesë të shpëtimit. Në këtë rreth, nga një projeksion idealizues arrihet në një utopi negative. Në skenë ndodh vrasja si shenjë konkrete e agresivitetit njerëzor: Mashkulli e vret Femrën, vritet dashuria.

Vox clamantis in deserto (Pashku et al, 1971:10) qe një tekst problemor dhe estetik, një manifest, që i shpallte luftë realizmit socialist, gjeëgjësisht ideologjisë social-komuniste. A.P. ishte *spiritus movens* i këtij “Manifesti”.

Vepra e A.P. është ndjekur me interes që nga paraqitja e parë. Vlerësimi i saj është bërë në Kosovë, thelbësisht; e botuar në përkthim në idioma ballkanike e përendimore me inteligjencë; e në Shqipëri më vonë. Egzegetët e veprës së tij janë: M. Raifi, që e ka krahasuar veprën e tij dramatike me dramën moderne të Sartrit, Beketit e Joneskos, ndërsa cilëson se *Kulla* është tregimi më i mirë që ai ka shkruar (Raifi, 1998: 83); dhe S. Hamiti, që e ka interpretuar veprën e tij në kontekst të letërsisë moderne shqipe. I. Rugova A.P. e cilëson si *Xhojsin e literaturës shqiptare* (Rugova, 1995:8). K. Shala e sheh A.P. në qendër të qarkut letrar të Prishtinës. Studiuesja franceze Ch. Montécot vlerëson: *Anton Pashku mbetet autori dramatik më i njohur në Kosovë* (Montécot, 2000:9); ndërsa R. Elsie e rendit *ndër stilistët më të mirë të letërsisë shqiptare* (Elsie, 2011:244). Vepra e A.P. është vlerësuar me *Shpërblimin e Dhjetorit* për letërsi. A.P. ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Bibliografi:

Pashku et al., Anton: *Vox clamantis in deserto*, bot. Rilindja, 2 tetor 1971.

Raifi, Mensur: *Mozaik letrar I*, bot. Dukagjini, Pejë 1998.

Rugova, Ibrahim: *Bujku*, 2 nëntor 1995.

Montécot, Christiane: *Préface* në Anton Pashku, *Fièvre*, éditions du *Petit Véhicule*, Paris 2000.

Elsie, Robert: *Fjalor historik i Kosovës*, bot. Skanderbeg Books, Tiranë 2011.

Hamiti, Sabri: *Anton Pashku*, bot. Albas, Tiranë 2107.

Shala, Kujtim M.: *Vox-i i Anton Pashkut*, bot. Buzuku, Prishtinë 2002.

Krasniqi, Nysret: *Libri i Pashkut*, bot. Buzuku, Prishtinë 2005.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK)

Artikull i madh, 8.906 shenja, përgatiti Mehmet Kraja

ASHAK është institucioni më i lartë i shkencës dhe artit në Kosovë, me seli në Prishtinë, themeluar me vendim të Kuvendit të Kosovës më 20 dhjetor 1975. Me ligj ASHAK përcaktohet si institucion i pavarur, që bashkon në anëtarësinë e vet shkencëtarë e artistë nga më të shquarit në vend (FESH 2008:33). ASHAK është institucion pa kompetenca ekzekutive, me ndikim moral dhe intelektual mbi zhvillimet e përgjithshme shoqërore, në mënyrë të veçantë në zhvillimin e mendimit shkencor, në veprimtaritë publike, arsimore, kulturore e artistike. Financohet nga buxheti i Qeverisë së Kosovës.

Statusin e institucionit përfaqësues të shkencave dhe arteve e konfirmuan edhe dy ligjet për ASHAK, pjesërisht ai i vitit 2004 i hartuar dhe i miratuar sipas legjislacionit të UNMIK-ut dhe ai i vitit 2015, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (Ismajli 2005:11). ASHAK aktualisht funksionon sipas *Ligjit për Akademinë* (Ligji nr. 05/L-038); ka numër të pakufizuar anëtarësh, ndërsa zgjedhja e anëtarëve të rinj bëhet çdo 4 vjet, sipas një rregulloreje të veçantë, mbështetur në propozimet e institucioneve të arsimit të lartë dhe të instituteve shkencore, me kufizim moshe deri në 65 vjeç. Sipas ligjit, ASHAK përbëhet nga punonjës të shquar të shkencës dhe të artit në vend, ka anëtarë të rregullt, anëtarë korrespondentë, anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi. Ka tri organe drejtuese kryesore: kuvendin, kryesinë dhe kryetarin. Kuvendi është organi më i lartë dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e Akademisë. Ai është organ vendimmarrës, që miraton aktet nënligjore, statutin, rregulloret e ndryshme; programin e punës e planin financiar; zgjedh anëtarët e rregullt, anëtarët korrespondentë, anëtarët e jashtëm e anëtarët e nderit; zgjedh kryesinë; krijon seksione, bërthama të studimit, njësi shkencore e qendra studimore. Kryesia zbaton vendimet e Kuvendit dhe përbëhet nga kryetari, nënkryetari, sekretari shkencor, sekretarët e katër seksioneve: të seksionit të gjuhësisë e letërsisë, të seksionit të shkencave shoqërore, të seksionit të shkencave të natyrës dhe të seksionit të arteve. Zgjedhja e organeve drejtuese të ASHAK bëhet çdo katër vjet dhe të drejtën për t'u zgjedhur e kanë të gjithë anëtarët e Akademisë nën moshën 75 vjeç (FEK, 2018:32).

Veprimtaria e ASHAK është me interes publik e kombëtar. Qëllimi i saj është nxitja e zhvillimi i punës kërkimore-shkencore e artistike në Kosovë; përkujdesja për zbatimin e arritjeve shkencore dhe për kultivimin e vlerave artistike në vend; si dhe zhvillimi i bashkëpunimit shkencor dhe artistik ndërkombëtar (FEK, 2018:31).

ASHAK u themelua në disa rrethana specifike të zhvillimeve shoqërore e politike që paraprinë, me zgjerimin e autonomisë së Kosovës në kuadër të ish-Jugosllavisë dhe me shtimin e kompetencave vendimmarrëse të organeve ligjvënëse të Kosovës. Me avancimin e statusit të Kosovës si njësi autonome në ish-Jugosllavi në fund të viteve 1960 dhe në vitet 1970 ndodhi një zhvillim i shpejtë social-ekonomik dhe një prosperitet i përgjithshëm institucional i Kosovës. Në fillim të viteve 1970 u intensifikua arsimi i lartë, që rezultoi me themelimin e Universitetit të Prishtinës (1970) dhe të një sërë qendrash studimore në kuadër të katedrave dhe fakulteteve.

Në këtë kuadër, më 1974, pranë Kuvendit të Kosovës u ngrit një komision për themelimin e Shoqatës së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Një vit më vonë, komisioni zgjodhi 11 anëtarë të rregullt dhe 2 anëtarë korrespondentë të kësaj shoqate. Kryetar i shoqatës u zgjodh Esad Mekuli, ndërsa ligji për themelimin e Akademisë u nxor më vonë, më 18 prill 1978 (Ismajli, 2005:10). Në këtë periudhë ASHAK e koordinonte veprimtarinë e saj me Universitetin e Prishtinës dhe me

qendrat e studimeve në katedra dhe fakultete, me institutet e pavarura (Instituti Albanologjik dhe Instituti i Historisë), si dhe institutet që ishin ngritur pranë qendrave të mëdha të prodhimit (*Trepça, Elektorekonomia, Agrokosova* etj.). Gjatë atyre viteve ASHAK i zhvillonte marrëdhëniet ndërkombëtare përmes Unionit të Akademive të Shkencave dhe të Arteve të Jugosllavisë, ku bënte pjesë dhe kishte status të barabartë me akademitë e tjera të ish-federatës jugosllave (kryesoi Unionin për një mandat, 1985-1987).

ASHAK në periudhën e parë e zhvillonte aktivitetin përmes tre seksioneve: 1. Seksioni i gjuhësisë, letërsisë dhe arteve; 2. Seksioni i shkencave shoqërore dhe 3. Seksioni i shkencave të natyrës. Më 1985 Kuvendi i ASHAK mori vendim të kompletonte funksionimin e institucionit, duke themeluar arkivin dhe bibliotekën dhe më pas duke hapur rrugën e themelimit të instituteve, siç ishte ai për arkeologji dhe për etnografi. Mirëpo procesi i konsolidimit të ASHAK u ndërpre me rrënimin institucional që ndodhi në Kosovë nga pushtimi serb në fillim të viteve 1990. Financimi i veprimtarisë së saj u ndërpre që në vitin 1990, ndërsa më 1992 u mor vendimi për suprimimin e saj (Ismajli, 2005:10), që rezultoi me ndërhyrjen e policisë serbe në godinën e Akademisë (1994) dhe shkatërrimin e arkivit dhe të bibliotekës (Ismajli, 2005:10).

Pas vitit 1999 nis një fazë e re e zhvillimit dhe konsolidimit të ASHAK. Në kushtet e reja të Kosovës së pavarur, ASHAK konsolidon legjislacionin dhe anëtarësinë e saj, ndërmerr aktivitete të dendura në fushën e kërkimeve shkencore (projekteve), të konferencave dhe të tryezave shkencore, si dhe të aktiviteteve artistike. Përgjatë këtyre viteve ASHAK mbajti një numër të madh konferencash nga të gjitha fushat i dijeve shkencore, nga gjuhësia dhe letërsia, nga shkencat juridike dhe ekonomia, nga historia dhe shkencat sociale, nga shkencat e natyrës dhe ato teknike dhe njëkohësisht u realizuan projekte të shumta me vlerë për dijet fundamentale dhe shkencat e aplikuara. Shquhet veçmas veprimtaria botuese, duke bërë që ASHAK gradualisht të kthehet në botuesin kryesor të veprave shkencore në Kosovë, me një përfshirje të gjerë të fushave dhe profileve, duke filluar nga albanologjia (gjuhësia dhe letërsia); historia, ekonomia, shkencat politike dhe juridike; shkencat sociale, filozofia, arkeologjia; gjeografia, demografia; shkencat teknike, matematika, biologjia, kimia etj.; një sërë botimesh nga fusha e arteve pamore, katalogë dhe monografi, si dhe vepra autoriale të fushës së muzikës, përfshirë edhe disa vepra enciklopedike.

Deri më sot nga ASHAK janë botuar mbi 420 vepra shkencore autoriale, monografi shkencore, përmbledhje studimesh, vepra të plota ose të zgjedhura të albanologëve botërorë (Jokli, Savicka, Joseph, Fiedler, Nahtigal, Gut, Savoia, Altimari, Hamp, Cimohovski, Pedersen etj.); veprat e plota të Idriz Ajetit, Gazmend Zajmit, të Selman Rizës dhe të Ali Podrimjës; veprat enciklopedike si monografia *Kosova* në shqip dhe anglisht, *Fjalori Enciklopedik i Kosovës* me rreth gjashtë mijë zëra dhe leksikoni *Vendbanimet e Kosovës* në tre vëllime (Kraja, 2022:9).

Që nga themelimi i saj ASHAK ka botuar disa revista shkencore. Në periudhën 1976-1990 është botuar revista *Acta biologiae et medicinae experimentalis* në 15 numra, ndërsa në vitin 1994 u themelua revista *Studime*, deri më 2023 në 27 numra (vëllime), në fillim me përfshirje të gjerë të të gjitha fushave të shkencave shoqërore dhe filologjike, për t'u kthyer së fundi në revistë ekskluzivisht për studime filologjike. Disa vjet më parë, u ndanë më vete revista *Studime shoqërore*, deri më 2023 në 8 numra, dhe *Kërkime / Research*, që botohet edhe në anglisht.

ASHAK është anëtare e Federatës së Akademive Kombëtare të Europës (ALLEA), e Unionit Akademik Botëror dhe e Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve për Europën Juglindore (AIESEE), si dhe bashkëthemeluese e Unionit të Akademive të Europës Juglindore, anëtare e Rrjetit Ndërkombëtar të Drejtave të Njeriut (FEK, 2018: 9). ASHAK ka marrëveshje të veçanta bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, me ato të Malit të Zi, të Maqedonisë, Kroacisë, Sllovenisë e Austrisë; me Akademinë Mbretërore Belge Flamane, me

Akademinë Italiane, me Akademinë Britanike, me Akademinë e Shkencave të Gëtingenit dhe me Akademinë *Leopoldina* të Gjermanisë etj. **M.K.**

Bibliografi:

Ismajli, Rexhep: *Një historik i pazakonshëm, 30 vjet të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës*, Prishtinë 2005.

Ismajli, Rexhep: *Historiku i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, 40 vjet të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, parathënie*, Prishtinë 2015;

Kraja, Mehmet: *Rreth veprimtarisë botuese të ASHAK, parathënie e Katalogut të botimeve të Akademisë (1975-2022)*, Prishtinë 2022.

Ligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (Ligji Nr.05/L-038), Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 2, Prishtinë 8 janar 2016.

Fjalori Enciklopedik i Kosovës, vëll. I, Prishtinë 2018.

Koliqi, Hajrullah, *Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK)*, Prishtinë 2018.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëll. I, Tiranë 2008.

Hebrenj antifashistë dëshmorë

Artikull përmbledhës, 5544 shenja, përgatiti Shaban Sinani

Megjithëse si rregull nuk u përfshinë në luftë dhe organizatat politike të kohës qëllim kryesor patën fshehjen e mbrojtjen e tyre në popull, një numër hebrenjsh të strehuar prej shqiptarëve, rezidentë a të ardhur, u *bashkuan vullnetarisht me antifashizmin* si pjesëmarrës aktivë në njësitë partizane. Në Shqipëri dhe në Kosovë janë shpallur zyrtarisht dëshmorë së paku 20 hebrenj, por numri i tyre mendohet të jetë më i madh.

Hebrenjtë antifashistë u bënë simbolikisht pjesë e qendresës së popullit shqiptar. I pari që bëri të njohur pjesëmarrjen antifashiste të hebrenjve në luftë në Shqipëri ishte ing. Samuilo Mandil, edhe vetë hebre (*Bashkimi*: 1945). Mandil kërkoi që të *shpalleshin dëshmorë të popullit shqiptar* pesë hebrenjtë e rënë në luftë: Jakov Avramoviç (Avramović), Jusef Konforti, Jusef Buvas, Zhak Ruben e David Koen. Më vonë, me vendime zyrtare, në Shqipëri u shpallën dëshmorë edhe 11 hebrenj të tjerë, midis tyre edhe hebrenj të përfshirë në luftën antifashiste në Kosovë.

Në burimet arkivore përmenden rregullisht *hebrenjtë e rrezikshëm për veprimtari subversive bolshevike, komuniste dhe antifashiste*. Në një dokument të kohës hebreu Paul Shapiro, i ardhur në Shqipëri nga Parisi, konsiderohet i *dërguar i Comintern-it për veprimtari antifashiste* dhe urdhërohet kërkimi i tij.

Në Berat, ku përqendrimi i hebrenjve ishte më i madh, më 23 qershor 1943 kërkohet largimi i menjëhershëm si *kundërshtarë politikë* i 39 hebrenjve. Nga hebrenjtë e Beratit Jakov Bahar u vra si antifashist në betejën e Tendës së Qypit dhe njihet si dëshmor; të rinjtë Bela e Rudi Bahar morën pjesë në themelimin e batalionit partizan *Margarita Tutulani*; vëllezërit Manuel e Viktor Dedok dhe hebrenjtë Pepe Kantozi, Manuel e Mosha Rubeni e Albert Josef Asheroviç (Asherović), morën pjesë aktive në luftën kundër pushtuesit nazist. Isak (Zhak) Ruben dhe Berta Ruben Zenuni, hebrenj të Beratit, janë shpallur dëshmorë të popullit shqiptar në dekadat e fundme.

Në Shkodër familja Arditi ishte bazë mbështetëse e antifashizmit. Dario Arditi mori pjesë në luftë si luftëtar i armatosur dhe është shpallur dëshmor i popullit shqiptar. Vëllezërit e tij: Luka, Leon e Ugo Arditi, bij të Zhak Arditi, pronar i një farmacie, u internuan në kampin e përqendrimit në Dachau si mbështetës të lëvizjes antifashiste dhe nuk e kanë ende statusin e dëshmorit.

Në Bishqethëm gjendet një varr pa emër, për të cilin thuhet thjesht *varri i hebreut partizan*. Leo Tyjer, Baruh Baruhovich dhe Amuras Moiseb, janë tre hebrenj të tjerë të rënë në luftë për lirinë e popullit shqiptar, të shpallur dëshmorë shumë vonë. Në varrezat e dëshmorëve gjendet varri i partizanit hebre me emrin Leo, i paidentifikuar plotësisht. Berta Ruben Zenuni është e vetmja partizane hebreje e rënë në luftë për lirinë e Shqipërisë (Sinani 2014:323).

Në Kosovë, qysh në vitin 1941, dy hebrenj vendës i qenë bashkuar qëndresës antifashiste, më vonë të dy të shpallur dëshmorë të lirisë. Në Prishtinë vepronte *grupi i ilegales antifashiste hebreje*, i themeluar më 1941, me iniciativën e rabinit Josef Levi, që njihej me pseudonimin *Rabini i kuq*. Në një takim të muajit qershor 1941 u vendos mbledhja e fondeve për të mbështetur lëvizjen antifashiste. *Njësitë e prapavijës*, siç u quajt, me komandant Josef Levin, kishte dhjetë anëtarë, nga të cilët shtatë ishin hebrenj. Matilda Bahar Bukić ishte drejtuesja më e lartë e lëvizjes ilegale ndër hebrenjtë e Prishtinës, më pas pjesëmarrëse në luftë si partizane në Shqipëri. Pas luftës ajo dhe Rebeka Rubanović u nderuan me *Medaljen e kujtimit (Luftëtare e*

parë e vitit 1941). Nxënësja nga Prishtina Ruti-Ruhale Ahronović-Demiri u bashkua me rininë komuniste të Kosovës dhe ishte koordinuese e një grupi ilegal prej 15 të rinjsh hebrej. Në pranverën e vitit 1944, së bashku me Gani Demirin, kaluan në Shqipëri dhe u bënë pjesë e Brigadës I Sulmuese. Më vonë kaluan në Brigadën IV të Kosovës, ku u ngarkua me detyrën e shefit të shërbimeve mjekësore (Kedem 2023:19).



Rut Ahronović Demiri (e para nga e djathta), e lindur në Prishtinë, mes një grupi partizanesh

Mjeku hebre Raul Tajitelbaum, që erdhi në Shqipëri nga Kosova, vuri në dispozicion të lëvizjes antifashiste gjithë rezervat e farmacisë së trashëguar nga i ati. Në shtator të vitit 1943 së bashku me prindërit u rreshtua në njësitë partizane dhe shërbyen si mjekë të lëvizjes dhe të popullatës civile. Manuel Brohović, hebreo-shqiptar i Kosovës, ishte në shërbim të spitaleve partizane që në fund të vitit 1943 (Tajitelbaum: 43-44).

Mjeku Albert Josifi (Josipović) u rreshtua në radhët e partizanëve dhe në fillim të vitit 1943 iu bashkua Brigadës VII partizane shqiptare. Në vitin 1947 mori *medaljen e dëshmorit* të luftës antifashiste, që iu dorëzua personalisht nga kryeministri i atëhershëm i Shqipërisë (Kedem 2023:18).

Nuk ka pasur raste të pjesëmarrjes së hebrejve në organizata të tjera politike të kohës jashtë rezistencës antifashiste nacionalçlirimtare.



REPUBLIKA POPULORE E SHQIPËRI
MINISTRI E MËDITËS DHE SHËRBIMIT

Nr. 1023

Certifikatë

ALBERT JOSIFI

Udhëheqës i "Medaljes e Dëshmorit" me 100

*"Me anë të kësaj me vlerë të Mëdhtës së Mëdhtës së Shqipërisë
dhe me anë të kësaj ka të drejtë të shpallë të drejtë të kësaj me vlerë
me anë të kësaj të Shqipërisë dhe të Shqipërisë"*

MINISTRI
(Faqe e 2 e 2)
Pallos

PRIDHENTI
Edi Rama
Edi Rama

Bibliografi:

Jakoel, Josef: *Izraelitët në Shqipëri*, bot. Çabej, Tiranë 2023.

Mandil, Samuilo: *Izraelitët në Shqipëri*, botuar në *Bashkimi*, 20 shkurt 1945.

Cakrani, Kadri: *Të vërtetat e luftës sime: kujtime historike*, bot. Onufri, Tiranë 2020.

Sinani, Shaban: *Hebrenjtë dhe shqiptarët, prania dhe shpëtimi*, bot. Naimi, Tiranë 2014.

Tajjitelbaum, Raul: *Po, ishte keq për lavdi, intervistë e vitit 2018*, min. 43-44, *Yad Vashem* 2018.

Kedem, Efrat: *Hebrenjtë në Kosovë: integrimi, lulëzimi dhe mbijetesa në Holokaust*, libër i mësuesit, Tel Aviv 2023.

